

Akademik Jani Thomai, është gjuhëtari me më shumë studime shkencore monografike në Shqipëri. Kontributi i tij është i jashtëzakonshëm atë të frazeologjisë gjuhësore, të semantikës leksikore, të dialektologjisë, të fjalëformimit, të leksikografisë etj.

JANI THOMAI: SFIDA KRYESORE, RUAJTJA DHE MBROJTJA E GJUHES SONE AMTARE, SI TIPAR KRYESOR I KOMBIT



Bisedoi Andreas Dushi

KADARE merr
titullin “Nderi i
bashkisë Fier”:
për shkrimtarin,
dashuria dhe
mirëkuptimi i
lexuesve është
gjithmonë i
shtrenjtë.

**Epika e vdekjes në romanin
“Ar e fosfor”
të Romeo Çollakut**

Nga Alisa Velaj (fq.9)

Ndriçim i denjë i veçantive të letërsisë
gojore shqipe dhe i zhvillimit të saj

Nga Sabahajdin Cena (fq.10)

Një roman “puzzle” që vë në lojë
misteret dhe ironitë e jetës

Nga Arben Veselaj (fq.13)

Për vëllimin poetik “Shkreptimë e tjetër moti”
të Demir Gjergjit

(fq.12)

**DUKE HETUAR
LËVIZJET E SHPIRTIT**

Nga Fatbardh Amursi (Rustemi)

**A ËSHTË FAJTORE
ZONJA BOVARI?**

Nga Desara Tollumi (fq.24)



GEGNISHTJA - MALLKIMI DHE LAVDI I MARTIN CAMAJT

Nga Behar Gjoka

(fq.5)

“Jeta ime është një luftë për gegnishten, - thotë Martin Camaj,- një luftë për mbijetesën, frymën e qenies, të dikurshmen dhe ardhmninë, një luftë jo me mbetë gjallë, por me ruejt të pastër fillin e amës së gjuhës dhe artit, mbi të gjitha me shpëtue shpirtin krenar të shqiptarit”.

**ZELDA FITZGERALD
akuzoi për plagjiaturë
bashkëshortin e saj
shkrimtarin e njohur
F. Scott Fitzgerald**

Nga Cati Gaya (fq.21)



BIBLIOTEKË

Rexhep Ferri *(fq.15)*

Ra një mjegull e madhe

Mehmet Elezi *(fq.16)*

Grimca

Delvina Kerluku *(fq.17)*

*Nuk ka psherëtimë
vetëm në një urë*

David Foster Wallace *(fq.22)*

Përgjithmonë sipëran

Charles Baudelaire *(fq.19)*

Portrete të dashurash

Mbi monografinë “SANTORI- POET DHE DRAMA-
MATURG” të prof. Klara Kodra, (QSPA)

**NJË VEPËR QË U
MUNGONTE STUDI-
MEVE MBI ANTON
SANTORIN**

Nga dr. Sadik Bejko (fq.10)

JANI THOMAI: SFIDA KRYESORE, RUAJTJA DHE MBROJTJA E GJUHES SONE AMTARE, SI TIPAR KRYESOR I KOMBIT

Bisedoi Andreas Dushi



A. D: Prof. Thomai, ndihmesa që prej dekadash ju keni dhënë në studimin e gjuhës shqipe, është e mbetet një vlerë e rrallë. Sot, si mendoni, është bërë aq sa duhet me studimet në këtë fushë?

J. Th: Siç dihet, gjuhësia shqiptare nis me një fjalor, me *"Fjalorin latinisht-shqip"* të Frang Bardhit (1635). Prej këtij, veprat e studimet për shqipen, nga studiues shqiptarë e të huaj, janë të shumta, për të gjitha nënsistemet e gjuhës dhe historinë e saj. Nga shekulli në shekull ato janë zgjeruar e janë bërë më cilësore, në krahasim edhe të shqipes me gjuhë të tjera. Shumë gjuhëtarë shqiptarë e albanologë të huaj të shquar kanë dhënë ndihmesën e tyre në fondin tashmë të pasur të studimeve për gjuhën shqipe. Gjysma e dytë e shekullit të kaluar dhe këta dy dhjetëvjeçarë të shekullit tonë kanë qenë më të begatë, si në produktin shkencor, ashtu edhe në përpunimin e zbatimin e metodave bashkëkohore të studimeve. Por mbetet ende shumë për të bërë; si për studimin e çdo gjuhe, edhe për shqipen është e natyrshme të ketë përparim të mendimit shkencor e të metodologjisë së kërkimit, të ndiqen zhvillimet e pandërprera të gjuhës gjithnjë në lëvizje, siç është edhe vetë mendimi shkencor. Kështu, dyshoj se do të vijë një ditë e të themi "bëmë aq sa duhet". Por të bëjmë së paku aq sa mundemi.

A. D: A ishte gjuhësia një fushë thuajse e paprekur para se ju e të tjerë kolegë t'i përkushtoheshit asaj? Si i kujtoni fillimet tuaja?

J. Th: Nuk mund të them se gjuhësia ishte një fushë thuajse e paprekur para nesh, para brezit tonë. Trashëgimia jonë është e pasur, me personalitete të shquara gjuhëtarësh,

ne u brumosëm me atë trashëgimi dhe u rritëm nën udhëheqjen e drejtimin e atyre personaliteteve. Vepra e tyre do të jetë edhe më tej themel i fortë për studimet gjuhësore dhe për formimin e gjuhëtarëve të rinj. Unë e kolegët e mi kemi pasur mundësinë të përfitojmë nga krijimtaria shkencore e gjuhëtarëve më të shquar të kohës, si profesorët Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Selman Riza, Androkli Kostallari, Dhimitër Shuteriqi, Jup Kastrati, Aleks Buda, Kristo Frashëri, Stefanaq Pollo, Kolë Ashta, Vehbi Bala e shumë të tjerë (shumë prej tyre i kemi pasur edhe pedagogë), krijimtari që përbën fondin e artë të shkencës shqiptare. Unë vetë e kam marrë diplomën universitare me një temë dialektologjike, i udhëhequr nga prof. Mahir Domi, i cili, edhe kur u emërova në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë, më nxiti ta çoj më tej atë temë deri në përmasat e një monografie. Ndërkaq, nisa punën në Institut në Sektorin e leksikologjisë e të leksikografisë, duke qenë gjithnjë afër ndihmës së pakursyer e përkrahjes së plotë nga profesorët e shquar në Institut ose në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë. Ndihma e përkrahja e tyre e drejtpërdrejtë e nëpërmjet veprës shkencore ka qenë shumë e çmuar dhe e pandërprerë për ne e për të tjerë më pas dhe do të vijojë të jetë e tillë.

A. D: Ka hapur një diskutim, prej dekadash, por e përforcuar kohët e fundit, çështja e vendimeve që u morën nga Kongresi i Drejtshkrimit. Çfarë mund të thoni për këtë diskutim?

J. Th: Është folur dhe është shkruar shumë për këtë çështje e druhem se do të them gjëra tashmë të njohura për shumëkënd. Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1972) është një nga veprimtaritë shkencore më të shënu-

ara për gjuhësinë e kulturën shqiptare, do ta quaja "binjak" të Kongresit të Manastirit (1908) nga ideali i bashkimit kombëtar. Ai ishte kongres mbarëkombëtar, me delegatë e pjesëmarrës nga të gjitha trevat gjuhësore të shqipes, i paraprirë nga Konsulta gjuhësore e Prishtinës (1968), me thirrjen "një komb – një gjuhë letrare". Që të flasim këtu për pohime, si: Kongresi u bë nën diktaturë, shpërfilli gegërishten, ngurosi shqipen etj., më duket e tepërt, sepse është folur e është shkruar shumë edhe për këto mendime e kundër tyre, pra, nuk sjellim gjë të re. Pastaj, le të pranojmë që diskutimet serioze shkencore, edhe kundër, janë jo vetëm të përligjura, por edhe të dobishme. Pas shumë vitesh, më 2004, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në frymën edhe të Rezolutës së Kongresit të drejtshkrimit për të ndjekur zhvillimet e shqipes e për të bërë rishikimet e nevojshme në kohën e duhur, ngritën Këshillin ndërakademik për gjuhën shqipe, me gjuhëtarët më të përgatitur. Ky Këshill punoi për disa vjet (me ndonjë ndërpreje), diskutoi për çështje gjuhësore (leksikore, fonetike, gramatikore, drejtshkrimore etj.) dhe bëri propozime për plotësimin e dukurive gjuhësore të patrajuara, për njësimin e zgjidhjeve të ndryshme për raste të njëjta (f.v., sipas *"Rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe"* dhe *"Fjalorit drejtshkrimor të gjuhës shqipe"*, shkruhet *gojëtar*, por *lojtar*, kur kushtet fonetike janë të njëjta), për zgjidhje që nuk i qëndruan kohës, për thjeshtime rregullash etj. Natyrisht, vendimet për ndryshime që duhen zbatuar në gjuhën e shkruar mund të merren nga një institucion i njëjti me kongresin kombëtar për gjuhën. Për leksikun çështja është disi ndryshe nga drejtshkrimi, sepse norma leksikore është e hapur, sipas parimit "edhe...edhe..." (edhe *shpinë*, edhe *kurriz*; edhe *krye*, edhe *kokë*), jo "ose...ose" (ose *nana*, ose *nëna*; ose *mani*, ose *mëni*), sepse sinonimia në leksik është shprehje pasurie në gjuhë. Kriteret e normës leksikore janë të tjera. Por, siç thashë, kjo është temë për diskutime shumë të gjata. Kongresi nuk « krijoi » ndonjë gjuhë, ai përligji dhe formuloi rregullat e gjuhës letrare që ishte arritur tashmë në praktikën gjuhësore para tij. Me rëndësi është që shqipja standarde e ka sprovuar tashmë veten; përsosja, zotërimi e zbatimi i saj në veprimtaritë gjuhësore, në të cilat duhet të funksionojë, mbeten detyra të përhershme.

A. D: Së fundmi Akademia jonë e Shkencave ka paraqitur projektet e saj ambicioze, mes të cilëve është edhe *"Fjalori i madh i gjuhës shqipe"*; ndër hartuesit e tij bëni pjesë edhe ju. Si e shihni këtë ndërmarrje të guximshme?

J. Th: E shoh po ashtu si ndërmarrje të guximshme, sepse është ndërmarrje e vështirë. Projekti tashmë është miratuar nga Akademia jonë e Shkencave, po punohet në fazën e parë për ngritjen e grupeve të punës me leksikografët më të mirë që kemi dhe që kanë aplikuar të përfshihen në këtë projekt (redaksia, hartuesit, bashkëpunëtorët, grupi tekniko-shkencor), për nëngrupet sipas fushave leksikore të pasqyruara më pak në fjalorët shpjegues të deritashëm të shqipes, e kushtëzuar nga tipi i fjalorëve (leksiku dialektor e krahinor, terminologjia shkencore, krijimtaria gjuhësore në letërsinë artistike, huazimet më të reja, elektronika e informatika, financat, arti e kultura etj.). Madje



ka filluar puna për kartotekën e posaçme (*ad hoc*) të “*Fjalorit të madh të gjuhës shqipe*” (FMGjSh), me skanimin e mijëra faqeve të teksteve të shkruara, si edhe për frazeologjinë në fjalor. Dua të sqaroj që ky fjalor, me rreth 90 000 fjalë e rreth 10 000 njësi frazeologjike, do të hartohet sipas kriterëve të fjalorëve njëvëllimsh e do të mbushë një zbrazëti në tipologjinë e fjalorëve të mëdhenj. Gjithsesi ai do të pasqyrojë një pasuri të madhe të leksikut, të frazeologjisë e të semantikës leksikore e stilistike të shqipes dhe do t’u shërbejë ruajtjes së saj e shfrytëzimit nga kushdo që do të ketë nevojë për të (shkrimtarëve, përkthyesve, publicistëve, studiuesve, hartuesve të fjalorëve dygjuhësh etj.). Një fjalor i madh shumëvëllimsh, me 120 000, 130 000 a më shumë fjalë, deri te fjalori *thesaurus*, të themi edhe me rreth 200 000 fjalë, mbetet detyrë e së ardhmes. Fjalorët janë vepra të kërkuara dhe që përditësohen kohë pas kohe, duke ndjekur zhvillimet e gjuhës. Kjo detyrë e së ardhmes kërkon më shumë leksikografë të përgatitur mirë e më shumë kohë për ta përmbyshur. Mendoj se është e domosdoshme që më parë të ngrihet një institut i leksikografisë pranë Akademisë së Shkencave dhe të krijohet kartoteka kombëtare (digjitale) e leksikut të shqipes me lëndën e kartotekave që kemi në Shqipëri, në Kosovë, në Kozencë, në San Peterburg etj.

A. D: Krahastuar me fjalorët e tjerë, çfarë të veçantë e të reje do të sjellë në leksikografinë shqipe “*Fjalori i madh i gjuhës shqipe*”?

J. Th: Pak fola më parë edhe për këtë. “*Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*”, 1980, fjalor i tipit të mesëm nga numri i fjalëve (41 000), por afër tipit të madh njëvëllimsh nga gjerësia e struktura kuptimore, shpjegimi i kuptimeve dhe shënimet plotësuese për vlerat stilistike-emocionuese, bashkë me fjalorët e tjerë shpjegues pas tij (1984/2002, 2006, 2020) shkojnë deri 48 000 fjalë. Pra, FMGjSh do të ketë dyfishin e fjalëve e të frazeologjisë si lëndë të re leksik-

ografike. Fjalori i madh do të ketë struktura kuptimore e shpjegime më të gjera a më të plota. Para së gjithash ai do të sjellë për përdoruesit në një vepër pasurinë leksiko-frazeologjike e semantike të krijuar e të përdorur të 3-4 dhjetëvjeçarëve të fundit, nga fusha leksikore të reja a të papasqyruara sa duhet në fjalorët e mëparëshëm, do të shtojë vlerat me të dhëna për etimologjinë e fjalëve rrënjë, me emërtimet shkencore të bimëve e të kafshëve, me neologjizma të ditës të krijuara mirë e me vlerë pasuruese, me nuancat e reja kuptimore e stilistike-emocionuese të fjalëve etj. Burimet e lëndës do të jenë shumë të gjera, që nga kartotekat e leksikut të shqipes, deri te fjalorët shpjegues e të tipeve të ndryshme, te veprat e autorëve me leksik e frazeologji të pasur etj.

A. D: E quani të nevojshëm a të një rëndësie të veçantë pasqyrimin në të të atyre fjalëve që janë në shqip, por përdoren rëndomë gjegjëset e tyre në gjuhë të huaj?

J. Th: Kjo pyetje më duket se lidhet me konceptin e normës gjuhësore në fjalor. FMGjSh do të ketë dy funksione: *normativ* e *informues*, me një rritje të funksionit të dytë sipas lëndës që do të përfshijë. Norma leksikore do të përcaktohet ose duke lënë jashtë fjalë që nuk duhet të futen në fjalor (huazime shumë të kufizuara e të vjetruara, thuajse të harruara, si p.sh. *adalet*, *axheba*, *apet*, *zid* etj.; variante fonetike krahinore, si: *qy*, *qo*, *siri*, *shpi/shpaj*, *xërroj* “rrëzoj” etj.; keqpërdorime vetjake të folësve etj.), ose që duhen vënë e që cilësohen në fjalor si jonormë nëpërmjet referimit te sinonimi i saj normativ. Po jap dy shembuj: nuk ka përse të vihet në fjalor *kontestatorët* (e kësaj ideje...) për *kundërshtarët* (e kësaj ideje...); ose: nëse do të vihet *aggravoj* (situatën...), do të referohet te *rëndoj*.

A. D: Për të mbetur edhe pak këtu, si është raporti mes përdorimit të fjalëve të gjuhës shqipe dhe atyre nga gjuhë të huaja në të folurën e përditshme, jo vetëm në bisedat




vetjake, por edhe të atyre që kanë një lloj përgjegjësie shoqërore si medie, politika e deri edhe bota shkencore?

J. Th: Vërtet është për t’u shqetësuar, sidomos, ashtu si thoni ju, në ligjërimin publik. Në ligjërimin e disa personaliteteve publike me ndikim të drejtpërdrejtë e të fortë shoqëror, në disa medie etj. ka shumë fjalë të huaja të panevojshme, e theksoj të *panevojshme*, sepse huazime të domosdoshme të kohës, sidomos ndërkombëtare, veçanërisht kur shprehin koncepte të reja, do t’i pranojë edhe shqipja për të mos mbetur një gjuhë e mbyllur në një

Polifoto e kursit Gjuhë-Letërsi Shqipe, 1954-1958. I pari, majtas, lart, Ismail Kadare





botë të hapur. Përdorimi vend e pavend i fjalëve të huaja e ndot gjuhën tonë, dëmton identitetin e saj dhe, fundja, kujt i shërben? Sepse kushdo, kur flet a shkruan, synon që të kuptohet nga të tjerët, pra, përveç dashurisë e nderimit për gjuhën amtare, duhet vlerësuar edhe se kujt i drejtosh. Më e keqja është i ashtuquajtur "snobizëm lingvistik", përdorimi i fjalëve të huaja të panevojshme për të treguar gjoja kulturë, njohje gjuhësh të huaja etj. Shikoni edhe tabelat e dyqaneve e të lokaleve, 70-80% në gjuhë të huaj; kjo bëhet në Shqipëri për të huajt, apo për t'u mësuar shqiptarëve emërtimet e huaja! Shihni edhe disa emërtime të emisioneve në TV. Por, mendoj, më e rëndë se disa gabime drejtshkrimore e ndonjë fjalë e huaj e panevojshme, që mund t'i ndreqë një redaktor gjuhësor (e të tillë duhet të ketë në çdo institucion shtetëror, radio-televizion, redaksi, gazetë, shtëpi botuese etj., bashkë me fjalorë drejtshkrimor e shpjegues të përgjithshëm), është varfëria e ligjërimit, kur flitet e shkruhet me një fjalor me jo më shumë se 500 fjalë, me ngurtësi fraze, pa atë forcë që japin fjalët, frazeologjia e kuptimet e figurshme, të cilat shqipja i ka të pafundme.

A. D: Ka një teori, sipas së cilës fjalët e huaja hyjnë me një lloj arbitrariteti në një gjuhë amëtare për sa kohë kjo e fundit nuk i shpreh dot disa nocione e kuptime. Mendoni se vlen kjo edhe për rastin e gjuhës sonë?

J. Th: E thashë që fjalët e huaja, që vijnë si emërtime të koncepteve të reja, kryesisht si terma e sidomos kur janë ndërkombëtarizuar, do t'i pranojë edhe shqipja. S'ka si bëhet ndryshe, fjala vjen në shkencë, në elektronikë, në marrëdhëniet ndërkombëtare etj. Por shumë fjalë të huaja, që përdoren zakonisht në ligjërimit politik, në medje etj., nuk kanë lidhje me këtë e dëmtojnë edhe qëllimin e komunikimit gjuhësor. Vite përpara Akademia e Shkencave botonte te revista "Gjuha jonë" një rubrikë "Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj", madje hartoi e botoi edhe një fjalor të tillë (1, 1998). Kjo punë e mirë është ndërprerë.

A. D: Dihet që sot një pjesë e të rinjve lexojnë në gjuhë të huaj, ose origjinalin e autorit (kryesisht në anglisht), ose përkthimin. Ndikon kjo, sipas jush, në dobësimin e njohjes më të thellë të gjuhës amëtare?

J. Th: Padyshim që ndikon disi edhe në fjalorin e ligjërimit të tyre të përditshëm shqip. Kjo do të thotë që përpjekjet për të ruajtur pastërtinë e përligjur të gjuhës sonë duhen forcuar. Dhe nuk janë vetëm gjuhëtarët që e ruajnë atë, por të gjithë duhet të jenë të ndërgjegjesuar e të përgjegjshëm për shmangien e keqpërdorimit të gjuhës dhe të ndotjes së saj me lëndë të huaj të panevojshme. Para së gjithash është shkolla, ku duhet të jepet gjedhja e një gjuhe shqipe, të pastër, të pasur e të bukur, me aq shumë mjete të fuqishme, jo vetëm në orën e mësimit për gjuhën shqipe a për letërsinë. Po ashtu ligjërimit zyrtar, i medjes etj. duhet t'i shërbejnë këtij qëllimi.

A. D: Po për përkthimet në gjuhën shqipe, çfarë mendoni? E pasurojnë apo e varfërojnë gjuhën?




J. Th: Përkthimi varet nga përkthyesi, sa e njeh ai vetë shqipen e pastaj gjuhën e huaj nga përkthen, çfarë aftësie e shije gjuhësore ka, sa i vetëdijshëm e i kujdesshëm është për të dhënë më të mirën edhe nga ana gjuhësore. Në traditë ne kemi përkthyes të shkëlqyer (si Fan Noli), edhe sot ka përkthyes të mirë; ka edhe përkthime të dobëta, që nuk dëmtojnë vetëm shprehjen, por edhe përmbajtjen. Përkthyesi e ka qëllim të qëndrueshëm përkthimin me një gjuhë të pasur e të pastër. Natyrisht, ka rëndësi çka thua, por ka tëndësi edhe si e thua.

A. D: Nëse Shekspiri mbahet themeluesi i gjuhës angleze, Dante i asaj italiane, a kemi ne ndonjë rast për gjuhën shqipe?

J. Th: Është fjala, besoj, për gjuhën letrare, për përpunimin e një gjuhe të pasur, të larmishme e të fuqishme, sepse krijuesi i gjuhës është shumë më i gjerë e më i hershëm. Nuk mund të lidhem pas një krijuesi të shqipes së kultivuar, shkrimtarët tanë të mëdhenj, përkthyesit e shquar, edhe publicistët e aftë kanë dhënë e japin ndihmesë të çmueshme për atë shqipe që mendoni ju.

A. D: Nisur nga mosha, kam përshtypjen se ju duhet të jeni i një brezi me shkrimtarin tonë Ismail Kadare. Sipas jush, ç'rol ka krijimtaria e tij në gjuhën shqipe?

J. Th: Po, të një brezi jemi, madje kemi qenë bashkëstudentë në Universitetin e Tiranës dhe bashkëkonviktore për katër vjet. Kemi qenë në grupin për gjuhë e letërsi shqipe, rreth 30 veta, të diplomuarit e parë të Universitetit (1958). Kemi marrë një formim të gjerë jo vetëm në



gjuhësi, me profesorët më të shquar të kohës, por edhe për letërsi e histori, sipas programeve mësimore në fuqi. Pas Universitetit nga ky grup 6 vetë hynë në shkencën e gjuhësisë, 4 vetë në krijimtari letrare, të tjerët me punë të dukshme e të frytshme në fushën e arsimit. Ismaili që atë kohë e kishte fituar emrin e poetit. Krijimtaria e tij e mëpastajme, aq e gjerë e cilësore, i dha emrin e merituar të shkrimtarit të madh shqiptar e botëror. Krijimtaria e tij, në poezi e në prozë, na vjen me një gjuhë të rregullt në drejtshkrim, të pasur e të pastër në leksik, të fuqishme, emocionuese e të këndshme stilistikisht e me këtë vërtetohet përsëri që shqipja i ka mjetet e veta ose mund t'i krijojë lehtësisht për të shprehur me magjinë e tyre barazisht ndjenjat më të holla dhe produktin e fantazisë më të thellë në krijimtarinë artitike. Nëse do të thosha diçka konkrete, do të cilësoja veçan aftësinë e ndiesinë e përpiktë të Ismailit për të krijuar fjalë të reja me mjetet e shqipes e sipas gjedheve të saj (f.v. *qelqnajë*, *sherrnajë* etj. sipas *akullnajë*), sidomos sintaksën e përkryer të një shqipeje standarde siç e duam. Natyrisht, si shkrimtari ynë më i lexuar i kohës sonë, sidomos nga të rinjtë e të rejat, ai e ka të lartë forcën ndikuese edhe në edukimin gjuhësor të lexuesve.

A. D: Ka pak vite kur gjuha shqipe u kthye në lëndë më vete (duke u shkëputur nga letërsia) në shkollat e mesme. Si e vlerësoni këtë vendim?

J. Th: Në kushtet tona e të gjendjes së sotme të shqipes, si flitet e si shkruhet, ky vendim është i drejtë e i shumëpritur. Kjo zgjidhje është diskutuar shumë që nga vitet '80 të shekullit të kaluar. Mbetemi me shpresën që të mos luhet shpesh me eksperimente për gjuhën shqipe në shkollë.

A. D: E parë nga syri i një studiuesi, cilat janë sot sfidat më të mëdha të gjuhës sonë?

J. Th: Sfida kryesore, sipas meje, është ndërgjegjësimi i përgjithshëm për ruajtjen e mbrojtjen e gjuhës sonë amtare, si tipari kryesor i kombit, rritja e përgjegjësisë dhe e rolit të institucioneve shtetërore, shkencore e arsimore, e medjeve dhe e gjithë atyre që kanë të bëjnë me gjuhën e ndikojnë mbi gjuhën. Këtu përfshihet edhe përballimi i trysnisë së dëmshme të gjuhëve të huaja mbi leksikun e shqipes.

A. D: Dhe në fund, mendoni se gjendja e studimeve të gjuhës është premtuese për të siguruar vijësinë ndër breza të atyre që vërtetë e duan dhe e studiojnë atë?

J. Th: Nuk dua të bëj pesimistin, disa dukuri të kohës (f.v. trysnia e anglishtes si gjuhë ndërkombëtare) nuk janë përjashtim për shqipen, edhe gjuhë të tjera kanë shqetësimet e tyre. Te ne nuk mund të them se gjuhësia nuk po e bën punën e saj me këto forca që ka, natyrisht duhet gjithnjë e më shumë, por ajo ka nevojë të mbështetet, të ndihmohet, të dëgjohet e të vlerësohet nga të gjithë për zgjidhjet që jep. Ndryshe thirrja e gjuhëtarëve mbetet zë në shkretëtirë dhe gjuha mbetet aty ku është a shkon më keq.

GEGNISHTJA - MALLKIMI DHE LAVDII MARTIN CAMAJT

Nga Behar Gjoka

"Jeta ime është një luftë për gegnishten, - thotë Martin Camaj,- një luftë për mbijetesën, frymën e qenies, të dikurshmen dhe ardhmninë, një luftë jo me mbetë gjallë, por me ruejt të pastër fillin e amës së gjuhës dhe artit, mbi të gjitha me shpëtue shpirtin krenar të shqiptarit".

Tekstet letrare/joletrare, gjuhësore/studimore, pa asnjë përjashtim, M. Camaj, i realizoi në gegnishte, pra në variantin letrar më të hershëm të historisë së gjuhës shqipe. Përveçse këtij varianti në krijimtarinë e gjerë dhe të larmishme letrare dhe studimore, kemi të pranishme një mori fjalësh të arbërishtes, një variant tjetër i hershëm dhe bashkëkohor i ligjërimit të shqipes. Madje, mund të themi se ky ligjërim, pra në gegnishten e përpunuar, shoqëruara me leksik të arbërishtes, kaq i shtrirë dhe funksional në veprën e tij, përveçse shenjë e vetëdijes autoriale, është dëshmi e ruajtjes dhe pasurimit të gjuhës shqipe në harkun kohor të bashkëkohësisë. Prania e gegnishtes dhe arbërishtes, me ngjyresa shprehëse dhe sendërtuese, pasuruese dhe përplotësuese të shkrimit në gjuhën shqipe, figuruese dhe plasuese të teksteve letrare, ka ndikuar në shpalimin e një realiteti letrar të mëvetësishëm dhe unik, vetjak dhe origjinal. Në këto dy koine, padyshim më të hershmet letrare, ku gegnishtja promovohet me Mesharin e Buzukut, e shoqëruar edhe me praninë e stilemave ligjërimore të arbërishtes, e cila e ka nisur shtegtimin me E Mbasme e Kërshtenë të Matrëngës, zë fill shkrimi i gjuhës shqipe, pamëdyshje edhe shkrimi letrar, andaj vijimi i lëvrimit të tyre në kushtet e ndalimit me ligj të pashpallur, por edhe në mungesë të atdheut dhe të shqiptimit të gjuhës amë, ndikon për ta parë kryekëput vetëm si një dukuri të vetvetishme dhe unike të letrave shqipe.

Unike si gjuhëshkrim dhe shqiptim letrar, e ngjizur me vetëdije dhe dëshirë kreative, veçmas si më e spikatur për harkun kohor të lavrimin dhe shpalimit modern të shqipes, të ngjeshur më shumë, me sprova të dështuara, të shkrimit si shërbesë dhe antishërbesë joletrare, por edhe me eksperimentin e pandërprerë të sendërtimit të artit të fjalës. Aq më tepër, që me veprën letrare të Martin Camajt, kemi të bëjmë jo vetëm me një zgjedhje autoriale, por edhe me një vetëdije shkrimore, shkencore dhe artistike, gjuhësore dhe letrare, të dëshmuar në morinë e kaq shumë teksteve letrare, ku gjejmë të lavruar të gjitha gjinitë dhe llojet letrare, mbase me faktin e një përgjegjëshmërie të lartësynuar shkrimore/letrare të mbajtjes gjallë dhe në lartësinë e merituar të këtyre dy varianteve të hershme të shkrimit letrar, pra të gegnishtes dhe arbërishtes, si një gjurmë ligjërimit e pashkëputshme, po kaq e evoluimit të thellë të gjuhës shqipe. Martin Camaj e lëvroi gegnishten dhe arbërishten, porse si pak të tjerë shkrimtarë të letrave shqipe, e pa letraren si një proces të shumëfishtë dhe si një proces eksperimental:

- Që përfshin brenda vetes njohjen e përvojës së mëhershme, të letërsisë së përbotshme dhe asaj të shkruar në gjuhën shqipe, gjithëkohore dhe gjithëhapësinore, çka dëshmohet me tepri në përthithjen e shumicës së teksteve të shkruara prej tij.

- Që përmbledh në vetvete praninë e eksperimentit letrar dhe gjuhësor, të gjerë dhe të përfunduar në shumicën e teksteve, si një akt që shkatërron rregullat fikse dhe njëherit shpik të tjera, ku do të majftonte sjellja në vëmendje e teksteve poetike Nema, Buelli dhe Palimpsest, si dhe teksti më natyrë sinkretike letrare, ku janë bashkëlidhur në një situatë të pashqitshme, poezia me prozën, pra Dranja ose kryevepra e shkrimtarit, siç e përcaktojnë lexuesit dhe studiuesit.

- Që mbetet tekembramja vetëmse një akt shkrimor autorial, që i mbishtresohet arritjeve të letrares në të gjithë

pentagramin e vet ekzistencial, gjë që preket sidomos nga lëvrimi i gegnishtes dhe prania e arbërishtes, gjithnjë në rrethanat e ndalimit të tyre, tashmë vetëm si akt letrar i pastër.

Prania dhe roli i tij si autor specifik dhe i papërsëdytshëm në letrat shqipe, si letrare dhe gjuhësore, sidomos i formatit të bashkëkohësisë, madje si një nga rastet e vetëdijshme kur dëshiron dhe aspiron, që ta zbulojë universin letrar të sendërtuar jo rastësisht me variantet e gegnishtes dhe arbërishtes, porse edhe si një fakt dhe dëshmi e kërkimit të vazhdueshëm të sprovës dhe eksperimentit letrar, që pa asnjë përjashtim përfundon me kualitet. Pohimi i bërë nga vetë shkrimtari, pamëdyshje në një çast dëshpërimi dhe vetëdije të plotë, më tepër ngjan me një thirrje dhe klithmë të mbrame të Martin Camajt, si një lajm dhe kumt i rrezikut të kanosur, sjell në fokus gjithë situatën e sipërmarrjes së ligjërimit, letrar dhe gjuhësor, studimor dhe të kritikës letrare, pikërisht në këto dy variante, por edhe të qasjes për t'i përkushtuar gegnishtes, por jo më pak edhe arbërishtes, në të gjithë jetën, si dhe në të gjitha aspektet e shpërfaqjes së tyre.

Këtë rrethanë e sqaron J. Lankshi, ish-student dhe përkthyes i disa teksteve të shkrimtarit, kur shkruan: Puna s'është që nuk e njihte gjuhën e unjisueme. Ai i njihte fort mirë të gjitha varietetet e gjuhës shqipe. Nuk do kishte pasë telashe me shkruar tosknisht apo unjisuemisht. As nuk shkruente gegnisht për shkak të njifarë komoditeti ose të të kenët i mësue me gegnishten. Camaj e përdori gegnishten në bazë të një vendimi dhe vullneti të kjohtë e të vetëdijshëm – me luftue për gegnishten. Pra, arbërishtja



dhe gegnishtja, sidomos kjo e fundit, gjithnjë simbas Joakim Lankshit, është përjetuar dhe projektuar nga shkrimtari si një aspiratë dhe betejë në mbrojtje të gjuhës dhe kulturës shqiptare, në mbrojtje të hershmërisë dhe mbijetesës së vlerave të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Këtu më tepër se gjithkund tjetër, në qasjet jo dhe aq të shumta ndaj autorit dhe veprës së tij, portretizohet figura madhore, letrare dhe gjuhësore e Martin Camajt, si dhe vetëdija e shpallur për të shkruar në këto variante letrare, e jo në gjuhën e njësuar. Po kaq rëndësi, në këtë kontekst dhe më gjerë se sa kaq, merr edhe pohimi i bërë prej tij, gati në mënyrë të drejtëpërdrejtë, që në fakt rreket të zbulojë tiparet më thelbësore të shkrimit të gegnishtes, si ligjërim shkencor dhe letrar të autorit, teksa shkruan: Duhet theksue se lufta e Camajt për gegnishten nuk ishte një luftë qorre, për gegnishten e kohës së Fishtës. Camaj angazhohej për parimin jo të divergjencës, por të konvergencës së gegnishtes me "gjuhën e njësuar », si një arsye më e fortë, që e zbulon realitetin dhe rrethanat e ndalimit, por i tipareve të ndryshme shkrimore, letrare dhe gjuhësore, krahasuar me shkrimin e Fishtës, patriarkut të poezisë epike shqipe, e mallkimit dhe sqarimit të mos përfshirjes së veprës së gjerë dhe përplot laryshi të Camajt, në meritën që bart letrarja e sendërgjuar prej tij, në vetmi dhe angëstini e mungimit të atdheut dhe njerëzve të dashur, ende sot e gjithë ditën, në panteonin e letrave shqipe. Në mbështetje të kësaj teze, që nuk ka gjasa të lihet përleshje debatit përmbi gjuhën dhe letërsinë për shumë kohë, në njëfarë mënyre është edhe A. Klosit, ku spikatet thënia e tij: Vepra e një jete me produktivitet të pazakontë mund të ndahet në veprim letrar, veprim filologjik, veprim kulturor. Ndërsa të parit i rri kurorë mbi krye poezia, veprimi filologjik përshkohet fund e krye nga rezistenca gjuhësore, shprehur në ruajtjen e gegnishtes letrare për brezat më të rinj, që në fakt e zbulon kontributin e tij në preken e shenjave të gjithanshme dhe përfaqësuese të veprës dhe të figurës së shkrimtarit, si dhe hedh piketa të qarta të trajtimit dhe verifikimit të kreatives, letrare dhe gjuhësore të sendërtuar prej autorit. Lankshi, në një pohim tjetër, në pamje të parë krejt si një rast i zakonshëm, në fakt zbulon dhe shenjon pengimin kryesor të teksteve të tij në marrëdhënie me lexuesin e sotëm, kur nënvizon: Gjuha e Martin Camajt mund të jetë një si pengesë tjetër në perceptimin e veprës së tij e cila nga shumëkush apostrofohet si ikonë e lashtë dhe e vyer, por njihet bukur pak. Gjuha e kësaj vepre, ndonëse është një gegnishte mjaft e moderueme, prapëseprapi e ballafaqon lexuesin jo vetëm me pasuninë e pazakontë të frazeologjisë së gegnishtes, por në radhë të parë edhe me jo pak lekseme pak të njohuna a të panjohuna – kjoftë nga leksiku i letërsisë së vjetër shqiptare, sidomos i asaj të arbëreshëve të Italisë, apo kjoftë edhe neologjizma të krijuar nga vetë Camaj.

Përcaktime të këtilla, sugjeruese dhe shpjeguese, tipizuese dhe karakterizuese, sa i përket natyrës së letrares së lëvruar nga Camaj, pra duke vijuar me vetëdije dhe magji shkrimi lavrimin e gegnishtes, si ligjërimit letrar dhe studimor, porse duke marrë dhe futur në tekstet e tij edhe shenja të përfillshme të arbërishtes, që në fakt jo vetëm në distancë kohore, por edhe në vijimësinë e qëndrimit të mbajtur ndaj tij, janë mallkimi dhe lavdia e shkrimtarit. Ligjërimit i gegnishtes, padyshim dhe përngjitazi me të, i shenjave të arbërishtes, përbën një rast specifik dhe unik në harkun kohor të letërsisë bashkëkohore shqipe, madje të vetmin akt të konsekuencës dhe koherencës për të ligjëruar me anë të tyre, edhe në mërgim, madje në kushtet e ndalimit të kthimit në dheun amë, por edhe të braktisjes absurde dhe pa një shpjegim logjik, të ligjërimit të gegnishtes edhe në Kosovë. Këtu, ndoshta me ndonjë përjashtim të

CAMAJ

VEPRA



Onufri

vogël, siç ka ngjarë fillimisht me tekstet në prozë të Anton Pashkut, të cilat u shkruan dhe lavruan në gegnishte, porse dikur-dikur, mbase trusuar nga rrethanat e pazakonta të standartizimit të ligjërimit letrar dhe gjuhësor, mjerisht si mënyrë funksionimi më tepër në nivelin e një rregulloreje të njësuar, pjesërisht ato tekste u përpunuan në situatën e ligjërimit të njësuar të gjuhës shqipe. Shkrimi letrar, në variantin e gegnishtes, me shenja të arbërishtes, përbën një akt dhe dëshmi të cilën lexuesë dhe studiuesë të ndryshëm e përjetojnë dhe trajtojnë në linja, shpesh krejt të përkundërta, midis tyre:

A - Linja zyrtare e të dy anëve të kufirit, pra qofshin profesorat dhe akademikët e Shqipërisë (të lëmit të studimeve letrare dhe gjuhësore), po ashtu ato të Kosovës, faktin e shkrimit të gegnishtes dhe arbërishtes e përjetojnë si një akt i ndryshëm, madje krejt i përkundërt me zhvillimin normal, që ka marrë gjuha dhe letërsia shqipe, fill mbas kodifikimit të saj, me norma dhe rregulla të një standardi detyrues (sa gjithnjë e më shpesh të përkujton një rregullore të mirëfilltë ushtarake, e cila në rrethanat e lirisë së shprehjes përfaqëson një pengojcë për shpërfaqejn e diversitetit gjuhësor dhe letrar) për gjuhën e komunikimit të gjerë, tipik në shkolla dhe administratë, në media dhe në mjediset shoqërore, por mjerisht me funksione unifikues për gjuhën e letërsisë. Pasojë e këtij gjykimi dhe qëndrimi, thelbësisht përjashtues dhe ngushtimi të hapësirave të ligjërimit letrar, madje me mangësi shkencore në marrëdhënie me realitetin ekzistencial të gjuhës shqipe, pra që nuk e vë në lëvizje idenë e diversitetit (ndryshueshmërisë) gjuhësor dhe letrar, patjetër si shenjë e përfaqësimit të qenies, ndonëse e pa shprehur hapur, jo prej padijes së tyre, por më shumë prej hipokrizisë së heshtjes bizare (nënkuptohet të botëkuptimit ideologjik dhe sociologjik), janë faktet e një formulimi të habitshëm të natyrës së krijimtarisë së shkrimtarit Martin Camaj, pra kryesisht si autor i së kaluarës, e më likshat ende si poet vetëm i gegnishtes, e jo i shqipes (sikur gegnishtja nuk i përket gjuhës shqipe), si poet cilësor dhe jo si prozator dhe dramaturg i letërsisë shqipe, pra gjithnjë duke ia mohuar ose harruar qëllimisht një pjesë të përfillshme të vlerave letrare të krijuara praj tij. Linja e mallkimit dhe ndalimit të Camajt, si emër dhe vepër gjuhësore dhe letrare, për faktin e lëvrimit të gegnishtes, si dhe më jo pak shenja leksikore të arbërishtes, përpos tjerash ka të bëjë, më tepër:

- Me përjashtimin nga hierarkia letrare, e variantit më të hershëm të letrave shqipe, pra të krijimtarisë së Buzukut, Budit, Bardhit dhe Bogdanit etj. , si dhe e kundërimit të këtij formati të ligjërimit parak dhe zanafillor të shqipes, nga një masë e përfillshme e studiuesve të zyrtarshëm, e tyre si vetëm me vlera gjuhësore dhe historike, pra duke ia mohuar praninë e vlerave letrare. Për shqyrtuesit zyrtar të letërsisë shqipe, letërsia e mirëfilltë zë fill me De Radën dhe N. Frashërin, që i përkasin shekullit të XIX, ku vetëkuptohet

se kemi një shpikje të radhës, me termin letërsi e mirëfilltë. Prej këtu merret vesh se pjesa e mëhershme, duke mos qenë e mirëfilltë, gjithnjë simbas studiuesve të zyrtarshëm, nuk i përket letrares që do të duhet të lexohet dhe konsiderohet si e tillë.

- Me shpërfilljen e ligjërimit të gegnishtes (po kaq të variantit të arbërishtes, porse me një fakt të shpërdorimit të saj diç më tepër, sepse ajo tashmë është përkthyer në shumicën e vetë, e pothuajse është zhdukur gjuha e autorit) edhe më përtej sinoreve zyrtare, para dhe mbas lirit të vendit nga pushtuesit e radhës, që të shpien krejt natyrshëm tek moti jo fortë i largët 1972, që kodifikoi njësimin e gjuhës shqipe, por bashkë më të realizojë, në mënyrë të fshehtë dhe të pushpallur me ligj, edhe ndalimin e ligjërimit të letërsisë me variantet e mëparshme, pra në gegnisht dhe arbërisht, që në fakt ligjërimin letrar të shqipes, nga me shumë ngjyresa, e unifikoi deri në shterpësi shprehëse, saqë shkrimtarët e periudhës unifikuese ngjajnë si të ishin vëllezër siamez dhe pa asnjë nuancë dallimi të ndërmjetshëm.

- Me pikësynimin e realizuar, tashmë në fshehtësi dhe pa asnjë rezultat me vlerë kodifikimi të shkrimit letrar, për përkthimin në gjuhën e njësuar të shumicës së teksteve të shkruara në variantin e arbërishtes (të De Radës, Serembes, Darës, pra jo transliterim i teksteve të tyre, por ndryshim vargësh dhe konceptesh), ndërsa ka shpëtuar Z. Skiroi, thjesht dhe vetëm nga fakti sepse ka qenë anëtar i partisë fashiste (çka bëri që të përzihej për shumë kohë nga panteoni i letrave shqipe), por edhe të ndonjë teksti në gegnishte, rrejtje të cilat mbetën në zgrip për shumicën e shkrimtarëve.

- Me ngritjen e nivelit gjuhësor, letrar dhe shkencor, veçmas të tjerëve, nga shkrimtaria e Camajt, një ligjërim letrar modern dhe një eksperiment i pandërprerë në të gjithë gjinitë dhe llojet letrarë, madje duke dëshmuar kështu qartësisht, me tekstet të shumta dhe të larmishme, se koineja letrare e gegnishtes, natyrisht pa harruar atë të arbërishtes, jo vetëm nuk ka vdekur, por ka të gjitha shanset e mbijetesës dhe të ligjërimit letrar në vijimësi, madje si një gjasë e përtrimjes së tij, në rrethanat e lirit prej detyrimit zyrtar, pengues dhe përjashtues.



Kuptohet se kjo linjë, e pranishme si nëntekst i mos shqyrtimit, pra duke e lënë më tepër si të nënkuptuar faktin e ligjërimit letrar dhe shkencor në variantin e gegnishtes (me jo pak fjalë nga arbërishtja), e sheh këtë fakturë artistike nga më origjinalet e ligjëratës letrare në gjuhën shqipe, sidomos të harkut kohor të letërsisë bashkëkohore, si një mallkim dhe pengesë për t'u përfshirë realisht në rrjedhat e letrave shqipe, e veçmas për t'u përfshirë në to si risim dhe eksperiment, që e mbajti të ndezur kandilin e ligjërimit letrar edhe në variantin e gegnishtes, po kaq edhe të arbërishtes. Në mënyrë fare absurde, gjithnjë sipas gjasash më shumë të shpaluara me nëntekst dhe heshtje

paradoksale, Camaj duke shkruar me këtë dialekt (variant letrar të hershëm dhe bashkëkohor), kinse ka shkruar kundër prirjes së unifikimit të gjuhës letrare shqipe, çka në fakt është e vërtetë vetëm në kuptimin rapsodik dhe jashtëgjuhësor të vështrimit të fatit të gjuhës shqipe. Porse, në mënyrë djallëzore dhe aspak shkencore, harrohet dhe nuk përfillet enkas, në këtë rast specifik të shkrimit letrar në gjuhën shqipe, posaçërisht në koinenë e gegnishtes dhe me praninë e leksikut dhe të trajtave ligjërimore të arbërishtes, fakti i shkrimit të letrares si gjuhë e autorit, e cila përgjithësisht i vë në dyshim dhe i rrëzon rregullat e shpikura të njësimi, dhe njëherit shpik dhe formaton disa mënyra të reja të shkrimit artistik, tashmë vetëm si gjuhë e letërsisë. Pra, duke mos i përfillur këto shenja, sidomos në nivelin e shkrimit letrar (poezi, prozë dhe dramatikë) rregullat e shkrimit të njësuar të letrares, ka gjasa që Camaj ta ketë vetëpërrjashtuar veten nga panteoni i letrave shqipe, pra ai ka hyrë dhe me gjasë do të mbetet si shkrimtari jashtë kohe, jashtë rrjedhave të ligjërimit letrar, madje edhe jashtë hapësirës së trojeve shqiptare, gjithnjë simbas optikës së pa artikuluar qartësisht dhe publikisht, së paku deri më tani, por të mirëmenduar nëpër vite nga studimtaria zyrtare. Kjo mençuri dritëshkurtër dhe pa perspektivë, mjerueshëm edhe e titujmbajtësve të shkencave letrare, akdemik dhe profesora, (të cilët rrëmojnë më kot nëpër letërkëmbime dhe thkellinat e biografizmit vulgar, me shpresën se do të zbulojnë atë që në fakt e bartin tekstet letrare, pra magjinë letrare), përgjithësisht dhe veçmas nuk ka lidhje me shkrimin e letrares, gjithnjë simbas teorive letrare, klasike dhe moderne, si gjuhë e letërsisë dhe gjuhë e autorit, dy tregues të vlerit të shenjimit të letrares, pavarësisht gjinisë apo llojit letrar.

B – Linja jozyrtare dhe diçka më tepër ajo antizyrtare, që zë fill dhe kulmohet me mendimet e Arshi Pipës mbi natyrën e krijimtarisë së Martin Camajt, përmbi përmasat dhe modelin letrar të këtij autori, e sidomos fakti i ligjërimit në variantin e gegnishtes, pamëdyshje edhe prania e disa formave të arbërishtes (siç ngjet me faqe të tëra në tekstin e romanit Karpa, por edhe diku tjetër, posaçërisht në prozat Shkundullima, Fshati me gjuhë të fshehtë etj.), po kaq si një tipar unik dhe adekuat i letrares së autorit, si një proces sprove dhe eksperimenti letrar, padyshim në shumësinë e vetë të përfunduar dhe me kualitet letërsishkrimor, shënon lavdi dhe mjeshtëri nga shkrimtari, gjurmë dhe dëshmi të shumta gjuhësore dhe letrare.

Lavdia dhe hyjnorja e Martin Camajt, si prani dhe frymë e teksteve letrare, gjithëgjinore dhe gjithzhanrore, po kaq e teksteve letrare dhe studimore, bart edhe shenja të tjera të dukshme dhe me vlerë jetike për shqiptimin letrar në gjuhën shqipe:

- Me shpresën se gegnishtja, varianti i parëlemë i gjuhës shqipe, nuk ka « vdekur » njëherë e përgjithmonë, siç edhe e menduan dhe projektuan ekspertët e prishjes së



normalitetit organik të ligjërimit letrar në gjuhën shqipe, gjithsesi nuk është tretur dhe shuar, ashtu siç e kanë dëshiruar dhe ëndërruar idhëtarët e zyrtarizimit të artit dhe gjuhës shqipe, pra në njëfarë mënyre të shkatërrimit të ekuilibreve të ligjërimit letrar si gjuhë e letërsisë dhe gjuhë e autorit, që në fakt standartizimi e sterilizoi si shprehësi letrare.


- Me aspiratën e shpallur me libra letrar dhe gjuhësor, që gegnishtja dhe arbërishtja dhe çdo ngjyresë tjetër letrare, nuk ka asnjë shans që ta ndërpresë rrugëtimin e vetë, jo vetëm sepse flitet në një hapësirë të konsiderueshme, si shtrirje dhe gjuhë e folur, ku jetojnë shqiptarët, brenda dhe jashtë kufijëve, por mbi të gjitha sepse ky variant është shkruar kaq bukur në pendën e Camajt dhe të disa autorëve të tjerë, pamëdyshje të të gjithë periudhave letërsishkrimore, saqë e vë në zgrip çështjen e njësimi të gjuhës së letërsisë, si unifikim i ligjërimit letrar.

- Me lartsynimin se gjuha e letërsisë, pra e thënë disi më ndryshe, gjuha e autorit, si shenjë e literaritetit në poezi a prozë, në dramatikë ose në verifikimin e studimtarisë, letrare dhe gjuhësore, nuk ka gjasa që të njësohet deri në shkatërrimin përfundimtar të artikulimeve autoriale, siç e sugjerojë dhe bëri ç'është e mundur që ta realizonte modeli zyrtar, gjuhësor dhe letrar i realizmit socialist, që dihet dhe është shqyrtuar pjesërisht se çfarë humnere krijoi në ligjërimin letrar të gjuhës shqipe.

Lavdia e Camajt, si shkrimtari i eksperimentit letrar, si dhe i autorit më modern të letrave shqipe bashkëkohore lidhet, sidomos me faktin e shkrimit letrar në koinenë e gegnishtes, si dhe në koinenë e arbërishtes, në kohën dhe kushtet e ndalimit të tyre, por mbi të gjitha emri dhe fama e tij, si lëvrues dhe shkrimtar modern, lidhet me sendërtimin e disa teksteve të befasishëm letrar, në poezi me librat Nema, Buelli, Palimpsest, në prozë me novelat e thukta të shkrimtarit, por edhe me romanet Rrathë dhe Karpa, doemos edhe me sinkretikën letrare, të pagjasshme në letrat shqipe, veçmas me tekstin Dranja, një rast që e tejkalon nivelin e shkrimit të letërsisë në gjuhën shqipe, e cila pamëdyshje rrok edhe qiej të tjerë letrarë, pa harruar këtu edhe dramatikën me tekstet Lojë mbasdreke dhe Kandilja e argjandit.

Përfjetimi i realitetit letrar, specifik dhe unik, etik dhe estetik, gjuhësor dhe filozofik, dëshmuës dhe shenjues, pikërisht ashtu siç e sendërton dhe ideon autori, pra në variantin e gegnishtes, si dhe me prekla të dukshme të arbërishtes, përbën një shkas për ta shijuar dhe kuptuar letraren e sendërgjuar prej tij, me aq veçanësi dhe finesë shkrimi. Termat, kinse shpjegues, përdorur me një shkujdesje të pa admirueshme, që nuk ka se si të të ngjallë shije pozitive, se i përket shkrimtarit të ekzilit, pra të mërgimtarit (kuptohet të përjetshëm), është një tjetër rrekje mejrane për ta shmangur, njëherë e përgjithmonë, Camajn dhe çdo shkrimtar tjetër, që nuk përfilli zyrtaritetin gjuhësor dhe letrar të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, nga panteoni letrar dhe shtjellat e ligjërimit modern të gjuhës shqipe. Toeria letrare, sidomos ajo moderne, më se njëherë sugjeron dhe sqaron se nuk ka peshë dhe rol parësor vendi se ku ka shkruar një autor, por gjuha dhe prania e shenjave letrare në një tekst, pra shqyrtimi i vlerës apo i mungesës së saj mbetet, gjithnjë dhe vetëm në marrëdhënie me letraren.

Shkrimtarët e ekzilit, pra mërgimtarët e përjetshëm, siç janë emërtuar nga studimet letrare zyrtare të shqipes, por edhe nga alabanologë të huaj, De Rada, Pashko Vasa, Naim Frashëri dhe Sami Frashëri, në të kaluarën e largët, Martin Camaj, Bilal Xhaferri dhe Arshi Pipa, autorë të rrafsheve bashkëkohore të ligjërimit letrar në gjuhën shqipe, nuk ka gjasa që të mbeten përjetësisht në udhëkryqin ekzistencial, të shpërfilljes përfundimtare, sepse na u përmendkërkanë ndonjëherë nga burokracia dhe studimtaria letrare, në ndonjë përvjetor, që pafundësisht dhe metodikisht, me ç'duket rreket vetëmse që t'i lërë jashtë rrjedhave të ligjërimit letrar në gjuhën shqipe si larmi dhe jo si unifikim mediokër dhe me vlera të dyshimta letrare. Zyrtariteti gjuhësor ka të bëjë më tepër me imponimin e shkrimit të letërsisë, vetëm sipas kodeve të rregullores drejtshkrimore, të miratuar në Kongresin e vitit 1972, nëse mund ta quajmë kështu ligjërimin e njësuar, i cili ka vënë në zgripin e mbijetesës gjuhën e autorit dhe të letërsisë, pra duke i larguar ato bukurshumë nga gjasat e shprehësisë letrare, ngjyresat e ligjërimit në këto variante (kuptohet në gegnishte dhe arbërishte), po ashtu zyrtarja letrare, lidhet vetëmse me modelin e realizmit socialist, të cilin shkrimtari i ligjërimit



në thyerje të gjuhës së standardit dhe i eksperimentuesit të formave të larmishme artistike, e përbuzi dhe as nuk e përmendi asnjëherë. Rrethimi i Camajt, por dhe i ndonjë shkrimtari tjetër të kësaj periudhe shkrimi, pamëdyshje e sidomos i krijimtarisë së larmishme letrare, në poezi dhe prozë, në dramatikë dhe studimtarinë gjuhësore dhe letrare, në qarkun përjashtues të kësaj përvoje shkrimore, madje nga më origjinalet në letrat shqipe bashkëkohore, pra si një mallkim krejt i pashembulltë, në historinë e letërsisë shqipe dhe më gjerë se sa kaq, kryesisht për faktin e ligjërimit të variantit të gegnishtes (me shenja të arbërishtes), njëherit nga ana tjetër, të lavdisë për këtë fakt shkrimi, mbase do të duhet parë si një shans i mbijetesës së këtij varianti, e sidomos i diversitetit (ndryshueshmërisë) letrar, gjuhësor dhe kulturor, do të duhet të ndërpritet si një shenjë e keqkuptimit paradoksal të veprës së gjerë dhe plot laryshi të krijimtarisë së tij, e cila në pjesën dërrmuese i përkon modernitetit dhe shpallimit të një eksperimenti letrar të përfunduar me kualitet shprehës. Tekstet e Camajt dhe të ndonjë autori tjetër, që i shkuan, me vetëdijë dhe funksion të shpallur, letrar dhe gjuhësor, përkundër zyrtaritetit të gjuhës dhe të letërsisë së kohës së mediokritetit zyrtar, e shpëtuan gjuhën dhe letërsinë shqipe nga përtharja e plotë si ngjyrim dhe shprehësi letrare. Por, në kushtet kur gjendemi, të hapjes dhe mbylljes ndaj shenjave gjuhësore dhe letrare, pra vetëm të pengimit absurd dhe të pamundshëm që të vijohet kështu përgjithmonshëm, për disa variante dhe të folme të shqipes, dy-tre akte, sa më shpejt që të jetë e mundur, duhet të marrin fund:

- Redaktimi gjuhësor, nëpër shtëpitë botuese (madje me ligje absurde mbi pengimin e ngjyresave të të folemeve përtej njësuarishtes, pra në mënyrë të posaçme i teksteve të shkruara në gegnisht dhe arbërisht), i librave me poezi, në prozë dhe dramatikë, përmes një standardi që ka të bëjë më tepër me komunikimin publik (pra kryesisht me atributin e gjuhës zyrtare) dhe jo aq shumë me gjuhën e letërsisë, pavarësisht mëtimin të tejzgjatun të gjuhëtarëve të zyrtarshëm.

- "Përkthimi", absurd dhe i pagjasshëm, që të ngjasë përjetësisht, i veprave të autorëve arbëreshë dhe të gegnishtes, sipas normës gjuhësore të standardit, sepse veçmas letrarja buron, gjithnjë sipas ligjësisë të artit të fjalës, prej diversitetit kulturor dhe gjuhësor, pra ca më tepër prej çunifikimit të rregullave të ditura, si dhe në shpikjen e rregullave të reja, gjithnjë në funksion të letrares dhe maturimit të saj me shenja estetike, pra si një ikje dhe kthim i pashmnagshëm në letërsi.

- Kthimi në gjuhën e njësuar të standardit, që në fakt i përjashtoi si gegnishten dhe arbërishten, të poezisë së Mjedës, De Radës, Serembes, Fishtës, Migjenit, Camajt, por edhe i prozës së Pashkut etj. , si detyrë e nxënësve dhe studentëve të shkollave shqiptare, pavarësisht se janë publike ose private, të larta apo të mesme, diç më e theksuar në Shqipëri, kryesisht pa i lexuar dhe kuptuar, pothuajse fare tekstet e këtyre shkrimtarëve.

Zgjerimi i gamës së problemeve, që mbështjellë shkrimtari dhe vepra e tij letrare, vetëm sa zbulohet i

plotë teksa sjell në fokus qëndrimin e vet Camajt, si një rruginë e munguar në shtjellimet letrare dhe gjuhësore të akademizmit shqiptar, zyrtar dhe jo zyrtar, kur shprehet: Besoj se tue ecë krahas gegnishtja e tosknishtja e shkrueme letrare, si dy motra të mira, pa ia pré rugën njana-tjetrës, kanë vijue mâ me fryt të gjëjnë pikat e përbashkëta, ku me të drejtë sugjerohet hapur se si do të duhet ligjëruar dhe lavruar gjuha e letërsisë. Madje, kjo vetëdije e qartë, gjuhësore dhe letrare, na zbulohet me akte të shkrimit letrar dhe jolettrar, të variantit të gegnishtes prej dhjetëra shkrimtarësh, por edhe prej Martin Camajt, madje në rastin e tij, në një kualitet të ngritur letrar, që vetiu të shpie tek vetëdija letrare dhe shkrimore e sendërtimit të aq shumë tekstesh letrare dhe shkencore në variantin e gegnishtes dhe dromca fjalësh të arbërishtes.

Gjasat janë që rishtas dhe pashkëputshëm, në mjediset zyrtare dhe jo zyrtare të akademizmit shqiptar, brenda dhe jashtë kufinjëve shtetëror, do të prekim vetëmse vijimin e dhunimit të gegnishtes dhe arbërishtes, si dhe të përjashtimit të zakonshëm nga panteoni i letrave shqipe të shkrimtarëve të saj, qysh me Buzukun, Budin, Bardhin, Bogdanin, Fishtën, Koliqin, Camajn, Reshpen, Pashkun etj. , ose më liksht ende të përkthimit të habitshëm (përshtatjes së mjerë), në gjuhën e standardit të De Radës, Darës, Serembes etj. , si dhe të vënies dorë në njësimin edhe të gjuhës së Konicës, Poradecit dhe të Paskos, çka do të thotë, as më pak e as më shumë, veçse ruajtje e piketave të vlerave gjuhësore dhe letrare të shpallura nga sundimi monist. Në mungesë të atdheut, në gjallje Camaj e kreu detyrën dhe misonin, e mbajti të ndezun kandilen e ligjërimit të gegnishtes, e tani në amshim u takon lexuesve dhe studiuesve që ose ta lënë jashtë rrjedhave të letrares ose ta përfshijnë në panteonin e letrave shqipe. Kthimi i Camajt, ligjëruesi dalëzot i gegnishtes, por nga ana tjetër kthimi i gegnishtesh do të thotë lartim dhe vlerësim i krijimtarisë së Camajt, mbetet një nyje gordiane, që kërkon mund dhe sakrifica, e mbi të gjitha lëshime shkencore të nevojshme, lejimin e lëvrimin letrar në këto variante të ndaluar. Nëse vonohemi, koha do ta bëjë me siguri, por bashkë me të koha do të hedh matanë jo pak shqyrtime, të kryera gjatë kësaj ndërkohje, në shumicën e vetë, pa i lexuar tekstet e Camajt. Prania si autor i bashkëkohësisë, që dëshiron ta zbulojë universin, me gegnishten, një fakt i sprovës dhe eksperimentit letrar, unike si gjuhëshkrim dhe shqiptim letrar, e ngjizur me vetëdije kreative, diçka shpëton nga nderi i humbur i letrares së shekullit të kaluar. Në thelbin e vet gjuha e standardit, si gjurmë dhe dëshmi formale, nuk presupozon ndalimin e gjuhës së autorit, e larmisë që bart dhe përçon gjuha e letërsisë, përkundrazi janë gjuhëtarët dhe një masë doktorë-profesorash të letërsisë, që duan t'i japin asaj një atribut, gati të pamundshëm për ta patur, për gjithnjë dhe për të gjitha hapësirat, si metodikë shkrimore, që në fakt do të thotë vyshkje dhe shkatërrim përfundimtar i letrares së ligjëruar në gjuhën shqipe, si larmi dhe diversitet gjuhësor dhe letrar.

EPIKA E VDEKJES NË ROMANIN “ARE FOSFOR” TË ROMEO ÇOLLAKUT

Nga Alisa Velaj



Romani “Ar e fosfor” i shkrimtarit Romeo Çollaku na servir nje subjekt disi të rrallë, jo vetëm në letërsinë pas viteve ’90, por për romanin shqiptar në përgjithësi.

Në qendër të tij hidhen dy personazhe të paemër, të cilët e bëjnë akoma më të çuditshëm këtë subjekt. De juro protagonistët e kësaj vepre janë tri, por de facto, ata janë dy. Edhe pse këta të fundit në fillimet e rrëfimit na duken si dy personazhe në një të vetëm, apo thënë ndryshe, si vazhdim i njëri-tjetrit (marrë kjo në kuptimin, Çiraku si trashëgimtar i Ustait), por, në të vërtetë, ata janë antipode të sho-shoq. Alterego që nuk arrinë të mësojnë në ç’vend e në ç’kohë ndodhen¹. E kjo vjen për faktin se koha nuk është kurrë kohë në këtë roman. Ajo kthehet vazhdimisht në antikohë, që në çdo moment pjell antikrishtët e saj. Por duke qenë se në thelb dy protagonistët de juro të këtij romani janë kaq të përkundërt, mund të themi se antikoha këtu ka ngjizur një antikrisht të pastër, një demon të vërtetë (Ustain) dhe një antikrisht të penduar, një Judë (Çirakun).

Këta antikrishtë hyjnë e dalin nga jeta tokësore në atë të përtejmen me një qellim të vetëm: të nxjerrin në pah dilemat e mëdha të shpirtit njerëzor².

Përrallë, fantazi e legjendë. Nga ana tjetër realitet dhe vërtetësi. Më pas, një përleshje e gjithë këtyre kategorive, për të krijuar realitet përrallë, përralla të realitetit, të vërteta fantastike, fantazi të së vërtetës. E mbi të gjitha, legjenda më shumë se të besueshme. Pikërisht këtu ngatërrohen dhe kufinjte mes jetës dhe vdekjes. Jeta si kohë dhe antikoha si vdekje.

“Ecnin. Të zhytur në të thella, të pagojë, shpërfillës ndaj natyrës dhe ndaj njëri-tjetrit. Sidomos ndaj njëri-

1 Sadik Bejko; Gazeta *Fjala*, Tiranë 2003, fq.3.

2 Po aty

tjetrit³”

Ftohtësia e vdekjes, si klimë mbizotëruese në këtë roman, ka ngjizur dhe brendinë e protagonistëve antipodë. Klisheja skeptike e Barthes-it “personazhi është ligjërata që ai prodhon”, formëson një teoremë të mrekullueshme në romanin “Ar e fosfor”. Antikrishti i penduar monologon, më tepër se sa komunikon, me antikrishtin e vërtetë. Madje edhe atëherë kur përpigjet të komunikojë, në të vërtetë ai s’bën gjë tjetër, veçse monologon me zë të lartë. Zgjimi ose ndërgjegjësimi i tij ka ardhur në çastin kur ka njohur demonët e vet. Megjithëse çdo gjë ka shkuar dalëngadalë drejt një fundi të pashmangshëm, gjuha e tij (Çirakut), është gjuha e makthit. Pasi te vdekja e tjetrit, ai ka nisur te ndjejë acarin e ftohtë të vdekjes së vet. Ndaj, në mënyrë krejt të natyrshme, ai është kthyer në një shpirt të trazuar.

Antipodi i tij (Ustai), ngase nuk e ndjen atë trazim në fyerjen ndaj të vdekurve, ka një gjuhë të metaltë, të ftohtë, dhe është shndërruar prej kohësh në një hije që ecën shpërfillës mes kufomash.

Në një vijë kohore të prekshme secili prej personazheve është vetëdija e munguar e tjetrit dhe kjo prani e vazhdueshme mungesash përcakton trajektoren e pakthyeshme nga jeta drejt vdekjes.

Kurreshtari → Çiraku → Ustai
(vetëdija e parë) (vetëdija e zgjuar) (mungesa e plotë e vetëdijes)

Brenda këtij raporti zinxhir qeniesh marrin trajtë dhe ato dilemat e mëdha të shpirtit njerëzor, të cilat bëhen të dukshme për një lexues model vetëm në një zbërthim alegorik te veprës, duke qenë se kjo e fundit cilësohet si një

3 Romeo Çollaku: *Ar e fosfor*, Shtëpia botuese “Spektër”, Tiranë 2006, fq.52.

4 Roland Barthes: *Hill and Wang*, New York 1974, fq.179.

proces retorik, me anë të të cilit një tekst ose imazh shpreh një koncept ose kuptim të fshehur, jo drejtpërsëdrejti të dallueshëm e të ndryshëm nga domethënia parësore⁵.

Gjuha e kureshtjes është vetëdija e munguar e fëmijërisë së Antikrishtit të penduar, dhe dialogu i tij i stërzgatur me qenien Kureshtar, i cili ndodhet nga ana e tij në dilemën e tmerrshme “të jesh a të mos jesh” mund të merret fare mirë edhe si monologu i munguar, që personazhi duhej të kish bërë prej kohësh me veten. Për të mos u shndërruar në një fëmijë-hajdut varresh, e më pas në një çirak të vdekjes. Gjuha e kureshtjes është gjuha e tij e munguar dhe dialogu me mbartësin e saj është nisja e fëmijërimit, ose thënë ndryshe procesit të kthjellimit në vetëdijen e tij. Këtu nis metamorfoza e pritshme e qenies në një shpirt të trazuar.

“Trupi nuk është si flaka. Sepse është braktisur nga jeta, nga shpirti. Shpirti po, shpirti është si flaka. Por jo si flaka e këtij zjarrit tonë, që, me të ikur ne, herët në mëngjes, do të jetë shuar. Shpirti është një flakë që nuk dihet kur është ndezur e nuk do të shuhet ndonjëherë”.

Vdekja e Kureshtarit është ndoshta më kuptimplotja në të gjithë veprën. Ajo nuk është gjë tjetër veçse një vdekje simbolike, ndërsa dialogu i tij me Çirakun e vdekjes shërben si një “diell alegorik” për këtë të fundit. Një diell që Çiraku vetëm sa e sheh, por nuk arrin të ngrohet dot prej rrezeve të tij, pasi tashmë është tepër vonë. Por ndërsa gjuha e kurreshtjes e shndërron çirakun e vdekjes në një qenie dilemash të tmerrshme, në një Antikrisht të penduar, kjo gjuhë nuk e prek asfare Ustain e vdekjes. Ai është tepër i moshuar për të tilla transformime, duke qenë se mbart në subkoshiençën e tij gjuhën e ftohtë të asgjësë. Me këtë gjuhë ky personazh ligjëron prej ferrit tij, që është tepër larg purgatorit ku po qëndron përkohësisht bashkëudhëtar i Çirak, dhe vite dritë nga rrethi ku lind gjuha e kurreshtjes. Pikërisht ngase nuk ka më asnjë lloj mundësie për t’u fëmijëruar qoftë edhe për një grimëkohe, ai ka humbur çdo lloj ndjesie njerëzore. E vetmja gjë ndaj së cilës tërhiqet si me magnet është ari në kockat fosforeshente të viktimave që përdhos netëve të pambarimta të mëkatit të tij. Mëkatet që nuk i rëndojnë aspak në ndërgjegje e bëjnë qenien Usta, personazh antipod me protagonistin tjetër të romanit. Dhe si për një rastësi “aspak të rastësishme”, tokat që në vend të të korrave shpërthejnë uturima, rënkimet e njerëzve të pafajshëm që do t’i nënshtrohen aktit makabër të murimit apo shpirti shegtar i vashës së vdekur ditën e martesës, të gjitha këto tmerre të marra së bashku, nuk janë ndodhi të pranishme në vendlindjen dhe monologët e Antikrishtit të vërtetë, por në kohën e hapësirën, nëpër të cilën vërtitet shpirti i trazuar i Judës, që me gjithë pendimin e tij s’e ndali dot lundrimin e pashmangshëm nëpër lumin Akeront. Duke qenë se arriti të fëmijërohej veç për një çast të vetëm, sa për të parë njëherë me sy të shqyer të vërtetat e tmerrshme. Sa për t’u shndërruar një kohë sa një e rrahur zemre, në Çirak dhe një pjesë të Kureshtarit⁷. E ardhmja e tij i ishte profetizuar qysh në ëndrrën e përbashkët të tri protagonistëve de juro. Ëndërr që përmbushi profecinë ogurzezë, se pendimi i vonë vlerë nuk ka.

“O për të menduar që pendimi i vonë vlerë nuk ka⁸”, siç jehon dhe zëri i arkitektit Çollaku, brenda ferrit që ai ka ndërtuar për antikrishtët e kësaj toke, e cila nuk ia fal askujt të shqetësojë prehjen e kockave të të vdekurve që mban përjetësisht në gjirin e saj.

Tiranë, nëntor 2010


5 *Dizionario della filosofia Garzanti*, Milano 2004, f.20

“Allegoria- Proc. retorica attraverso cui un testo, o un’immagine esprime un concetto o un senso riposte, non immediatamente intelligibile e diverso dal significato letterale”

6 Romeo Çollaku: *Ar e fosfor*, Shtëpia botuese “Spektër”, Tiranë 2006, fq.71.

7 Po aty, fq.83.

8 Po aty



Mbi monografinë “**SANTORI- POET DHE DRAMATURG**”
të **prof. Klara Kodra**, botim i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve
për Arbëreshët (QSPA)

NJË VEPËR QË U MUNGONTE STUDIMEVE MBI ANTON SANTORIN

Nga dr. Sadik Bejko

Monografia “SANTORI- POET DHE DRAMATURG” e studiueses Klara Kodra merr në shqyrtim poezinë dhe dramaturgjinë e Anton Santorit, autor i traditës romantike të letërsisë arbëreshe.

Synimi i punimit, sipas autores, është ky: “Kjo monografi, përveç dhënies së informacionit mbi krijimet e panjohura apo të pastudiara të Santorit, ka si synim vlerësimin estetik të krijimtarisë poetike dhe dramaturgjisë së shkrimtarit, zgjidhjen e disa çështjeve të diskutueshme që lidhen me këtë krijimtari dhe vendosjen e krijimtarisë në fjalë në kuadrin e gjerë të letërsisë arbëreshe dhe shqiptare të Rilindjes”.

Romanet e A. Santorit mbeten jashtë vëmendjes së kësaj monografie sepse, sipas autores, meritojnë një studim më vete.

Që nga strukturimi dhe synimi i punimit për ata që janë ndjekës të studimeve dhe të rrjedhave njohëse të letërsisë arbëreshe, krijohet kurioziteti shkencor për çfarë sjell ky punim. Kurioziteti shkencor nxitet prej asaj që prof. Klara Kodra me monografitë e saj mbi De Radën, Seremben etj., me një varg studimesh mbi këtë fushë të shkencës, studime dhe monografi të vlerësuara fort në mjedisin shkencor/akademik, është një njohëse dhe studiuese me themel e kësaj letërsie, e letërsisë arbëreshe të traditës romantike. Kurioziteti nxitet dhe se Santori mbetet një autor i suprizave më të mëdha nga gjithë shkrimtarët e traditës romantike arbëreshe dhe të traditës së gjithë letrave shqiptare në tërësi. Ai me kalimin e viteve, në vend që të harrohej si shkrimtar minor, ashtu siç u paraqit me botimet e njohura në gjallje të tij, erdhi në ngritje, erdhi duke u rritur në cilësi dhe në sasi botimesh. U zbuluan veprave të humbura, të panjohura, të mbetura në dorëshkrim, u vërejt një larimi gjinish letrare të trajtuara prej tij. Kështu njohja u pasurua

me një vepër voluminoze, me një prodhimtari të begatë në shumëllojshmërinë e saj, por fatkeqësisht të mbetur nën pluhurin e harruar të arkivave. Me kohë dorëshkrimet e trashëguara edhe u botuan, por ka të tjera që presin të botohen.

Kjo shpalosje veprash në rrjedhë të kohëve e tronditi njohjen shkencore dhe patjetër do të kërkonte ridimensionimin e vlerësimeve mbi talentin/talentet e tij, mbi begatinë e prurjeve të tij.

Pikërisht në këtë varg problemesh mbi një autor si Santori ndërhyjnë me studimin e saj prof. Klara Kodra. Duke qenë njëherësh poetë dhe studiuese e lindur, e kultivuar, në punimin e saj mbi një poet hyn dhe pasioni, dhe analiza e ftohtë e shkencëtarit me përvojë të gjatë krijuese, dhe kurioziteti për të pathënat e supozimet mbi personalitetin e atij murgut arbëresh, të Anton Santorit, një poet, dramaturg, komediograf dhe romancier i begatë, por përgjysmë nën hije.

Shqisa e mprehtë e intuitës shkencore të Klara Kodrës, parapërgatitja me njohjen e hollësishme të objektit në shqyrtim, e kanë orientuar drejt në atë mori studimesh mbi Santorin, studime shpesh kundërtënjohëse nga njohja e cunguar e një autori që përherë fshihej e rishfaqej me të papritura nga pluhuri i dorëshkrimeve të humbura e të rigjetura. Vetë autorja e studimit rrëfen shfletimet e materialit mbetur në arkiva, arkiva të shumta me të cilat ajo është konsultuar, rrëfen mbi botimet në Itali të veprave të panjohura të Santorit dhe përcjelljen studimore prej kolegëve të saj shkencorë, por edhe për transkriptime të bëra prej saj.

Siç shihet, kjo është një punë që ka kërkuar njohje, pasion shkencor dhe mundim murgu të një prej studiueseve tona të përkushtuara si Klara Kodra.

Në shqyrtimin e poezive lirike autorja vëren se prirja lir-



ike është një përbërës kyç i gjithë krijimtarisë së Santorit, prirje që nxjerr krye te poemat, te drama, te melodramat etj.

Do të ndalesha në veçanti në analizën e fabulave të Santorit. Studiuesja e vë këtë krijimtari në plan krahasimtar me Ezopin, La Fontenin, por dhe me përkthyesit shqiptarë të fabulave, me Naimin dhe Çajupin. Santori te fabulat më shumë se përkthyes, është përshtatës dhe rikrijues.

Me satirat që u zbuluan nga K. Kandreva, Santori “çau toka të virgjëra në letërsinë tonë” dhe mbetet një pararendës origjinal. Pas analizës, autorja mendon se individualiteti i tij shprehet më qartë përmes patosit satirik dhe humoristik. Ai solli një notë të re, një vull të veçantë dhe të theksuar në tërë letërsinë tonë të Rilindjes.

Vjershat fetare janë një shartim i himnit, baladës dhe i novelës, poezi që u paraprijnë romancetave.

Në veçanti dhe me frymëzim autorja është ndalur të dramaturgjia e Santorit që zë një vend kryesor në krijimtarinë e tij, si tragjediani i parë, me tragjedinë “Neomenia”, si dramaturgu i parë, me dramën “Emira”, si komediograf dhe autor melodramash. Sipas saj, “karakterin vullkanik të talentit dhe të frymëzimit” Santori e shfaq në dramaturgji. Ai është nismëtar i suksesshëm i shumë gjinive dhe llojeve në letërsinë tonë. Në këto vepra ndërthuren dramatikja komikja me aspektin lirik, si prirje e qëndrueshme e Santorit. Nga tetë melodramat veçohet për vlerat estetike të shënuara melodrama “Aleks Dukagjini”.

Me komeditë “Vejusha Koprace” dhe “Polikarpi” Santori mbetet themeluesi i komedisë në letrat shqipe dhe një komediograf i talentuar. Santori me autoironi e shfaq veten si krijues të pavlerë, por edhe si “cjav” nga që si klerik që ishte, ai u vardisej vajzave të bukura. Ky cilësim i Santorit si “cjav” ishte dhe opinioni i fshatarëve për priftin e tyre.

Melodramat dhe komeditë përkrijnë me vokacionin e tij prej dramaturgu.

Problematika e shumtë e dramës “Emira” vjen nga botimet e saj jo të plota. Analiza e dramës “Emira” është nga realizimet më të arritura të kësaj monografie. Duke ju referuar autorëve shkencorë të shumtë që kanë shkruar mbi dramën “Emira” dhe botimeve të herëpashershme të kësaj drame, Klara Kodra sjell argumente me vlerë mbi karakterin e dramës, mbi personazhet e saj, mbi problemin e realizmit si një tipar i krijimtarisë së Santorit.

Mjedisi letrar i kohës dhe i vendit ku jetoi dhe shkroi ky autor, ka sjellë dhe ndikimet tek ai. Klara Kodra si njohëse e mirë e letërsisë italiane, sjell përkime të krijimtarisë së Santorit me autorë madhorë italianë si Manxoni, Karduci, por edhe përkime me poetin Vincenzo Padula, një autor minor kalabrez. Santori ka përfutur nga ky mjedis krijues duke ruajtur individualitetin e tij. Po ashtu është vërejtur se krahas ndikimit të romantizmit të rrëmbyer kalabrez, te realizmi i Santorit ka ndikime nga verizmi italian, verizmi si një shartim i natyralizmit me realizmin.

Klara Kodra në mbyllje të monografisë arrin në këtë përfundim: “Santori është një shkrimtar që, në rrugën e vet krijuese, spostohet gradualisht nga periferia drejt qendrës për shkak të rolit të tij prej nismëtar, themelues të gjinive dhe llojeve të reja në lëvrimin e të cilave ka veçanësinë e vet dhe gjithashtu për shkak të teknikave të reja me të cilat e pasuroi letërsinë arbëreshe si edhe për evolucionin e tij drejt realizmit”.

Duke përdorur një metaforë të Dantes, autorja jep vlerësimin e vet se Santorin nga poet minor, siç e ka trajtuar deri më tani mendimi shkencor “do të mund ta vendosnim në ‘qiellin më të ulët’ të parajsës së poetëve. Vetëm një metaforë e tillë e guximshme do të mund ta përkufizonte këtë autor tepër interesant dhe të ndërlikuar”.



Anton Nikë Berisha, *Hyrje në historinë e letërsisë gojore shqipe*.
Shtëpia Botuese "Faik Konica", Prishtinë 2017, f. 622.

NDRIÇIM I DENJË I VEÇANTIVE TË LETËRSISË GOJORE SHQIPE DHE I ZHVILLIMIT TË SAJ

Nga Sabahajdin Cena



Ndihmesë e rëndësishme për studentët dhe studiuesit e letërsisë gojore

Në kohën kur, si studentëve të letërsisë gojore shqipe, mësimdhënësve e po ashtu edhe të studiuesve të këtij lëmi, u ishte tejte i nevojshëm një hulumtim dhe ndriçim në diakroni dhe sinkroni i kësaj letërsie, profesor Anton Nikë Berisha e pasuroi vargun e studimeve të tij me botimin e veprës "Hyrje në historinë e letërsisë gojore shqipe". Ky libër lëshon edhe një rreze drite në studimin e letërsisë gojore shqiptare që vjen si një pasqyrë e një udhëzues, përkatësisht si një çelës interpretimi me të cilin mund të hapet kjo godinë e madhërisë e njohur si letërsi gojore brenda letërsisë shqipe në përgjithësi.

Kjo vepër kulmore e hulumtimeve dhe e shkrimeve të prof. dr. Anton Nikë Berishës, studiuesve u erdhi pas veprave: *Mundësi interpretimi, Ese dhe vështrime*, Prishtinë 1979, *Teksti poetik. Vështrime e kritika*, Prishtinë 1985, *Veçanti ligjërimesh poetike*, Tiranë 1996, *Gjymtime dhe shëmtime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, Prishtinë 2001, *Çështje teorike të letërsisë*, Prishtinë 2005, *Njëmendësia e fjalëve. Mundësi interpretimesh letrare*, Prishtinë 2006, *Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë*, Kozencë 2008, *Këngë që përlligjin pasurinë shpirtërore të shqiptarit e të botës së tij. Mbi këngët kreshnike shqiptare*, Prishtinë 2008, *Vëzhgime teorike dhe estetike të De Radës dhe të Fishtës*, Tiranë 2011, *Larmi vëzhgimesh letrare*, Prishtinë 2012, *"Meshari" – vepër e hartuar nga Gjon Buzuku*, Fondazione Universitaria "Francesco Solano", Comet Editore Press, Kozencë 2014 (Botimi i dytë "Faik Konica", Prishtinë 2014), *Ligjërime rreth tekstit letrar poetik* (së bashku me Labinot Berishën), Prishtinë 2017, *Vëzhgime mbi "Poetikën" e Aristotelit*, Studim. Faik Konica, Prishtinë 2018, *Estetika dhe estetika e letërsisë* (së bashku me Labinot Berishën), *Qenësia e kumtit poetik. Libri i parathënies 2*, Faik Konica, Prishtinë 2019 e shumë vepra të tjera.

Libri është i ndarë në pesë pjesë dhe shoqërohet me aparaturë shkencore (fusnota e bibliografi) tejte të begatshme e njëherit edhe udhëzuese për studime edhe më të thella në fushën e letërsisë gojore, përballë historisë së zhvillimit dhe të ruajtjes së traditës së të kënduarit e të rrëfyerit si dhe të studimeve krahasimtare brenda dhe jashtëletrare në rrafsh të ndryshme, të tekstit, të tematikës dhe të motiveve.

Në pjesën e parë të "Hyrjes në historinë e letërsisë gojore shqipe" autori shtron çështje të përgjithshme të karakterit teorik e problemor të kësaj letërsie si: Poetika e letërsisë gojore përballë poetikës së letërsisë së shkruar, të përbashkëtat dhe veçantitë e tyre të artit të fjalës; merr në vështrim raportin e krijuesit gojor dhe përcjellësit gojor, duke vëzhguar mënyrën e lindjes, ligjet krijuese, zhvillimin dhe funksionimin e krijimtarisë letrare gojore. Studiuesi Berisha thekson se letërsia gojore, si art i fjalës së folur, nëpër shekuj qe krijimtaria shpirtërore, e cila me cilësitë e veta bëri atë që nuk mund ta bënte në atë mënyrë asnjë formë tjetër e artit që krijoi njeriu. Në këtë rrjedhë ai thekson se çdo krijimtari shpirtërore në zhvillimin e saj

ka dhe mbështetet në një traditë, e cila në intervale kohore pëson dhe transformohet, po asnjëherë nuk shkëputet krejtësisht prej saj. Edhe kur një krijimtari e një periudhe të caktuar i kundërvihet ose synon ta mohojë traditën ekzistuese, ajo në një mënyrë ose në një tjetër e determinon dhe ekzistimin brenda saj.

Këtë pjesë të librit të vet ai e përmbyllur me çështjen, përherë të rëndësishme dhe njëherit komplekse, të klasifikimit. Dukurinë e trajton nga aspekte të ndryshme. Ai thekson se klasifikimi në bazë të tematikës dhe të motiveve nuk sjell ndonjë rezultat të qëndrueshëm dhe i jep përparësi interpretimit të vetë veprave letrare gojore, strategjisë së rrëfimit, mesazhit artistik, mikro dhe makrostrukturës dhe elementeve të tjerë të rëndësishëm të krijimit letrar gojor, përkatësisht studimit të veçantë të vetë veprave konkrete të letërsisë gojore. Në këtë rrjedhë ai sjell mendimin e Horkheimerit dhe të Adornos, ku thuhet se klasifikimi është kusht për njohje, ai vetë nuk është njohje, ndërsa njohja e mënjanon klasifikimin.

Të dhëna të hershme të krijimeve të letërsisë gojore shqipe

Në pjesën e dytë të kësaj vepre, që bën pjesën më të rëndësishme të saj, prof. Berisha përqendrohet në të dhënat e hershme të ekzistimit të kësaj krijimtarie të shqiptarët, duke filluar nga viti 1474, që lidhet me të dhënë e historianit venecian, Anton Sabeliki rreth ekzistimit të këngëve për kryetrimin arbërorë, Gjergj Kastriotin Skënderbeun. Ai shënon se kishte dëgjuar këngë që këndoheshin dhe vallëzoheshin nëpër udhëkryqe e sheshe përmes të cilave himnizohet kryetrimi. Vazhdohet me të dhënat që jep Marin Barleti, i cili shkruan për ekzistimin e gjëmave dhe të vajtimeve, të dhëna që dëshmojnë edhe nga Dhimitër Frangu, Pjetër Budi, Evlia Çelebiut etj.

Në vijim autori thekson rëndësinë e rapsodisë së Pal Golemit të traditës së arbëreshëve të Italisë, të mbledhur nga prifti italian, Nilo Katalano para vitit 1693 (Katalano vdiq në Arbëri më 1693). Teksti i kësaj rapsodie u gjet në Fjalorthin në dorëshkrim italisht - shqip të këtij misionari italian. Po kështu autori ndriçon rëndësinë e madhe të "Dorëshkrimit të Kieu-tit" i vitit (1735-1750), ku pos shkrimeve të ndryshme, janë edhe 18 rapsodi arbëreshe.

Një interpretim të veçantë Berisha i bën përmbljedhjes me rapsodi arbëreshe të vitit 1866: "Rapsodi të një poeme arbëreshe", të mbledhur në kolonitë e rrethit të Napolit dhe botuar nga De Rada. Është nga vëllimet më të shquara të gjithë traditës letrare gojore arbëreshe dhe asaj shqiptare. Kjo përmbljedhje me rapsodi arbëreshe dallohet për vlera të larta shprehëse poetike, e cila ndikoi fuqishëm te disa shkrimtarë arbëreshë, midis tyre dhe të vetë De Rada. Me vlerat e tilla këto rapsodi zgjuan një interesim të madh ndër arbëreshë, por dhe ndër të huaj, sidomos ndër italianë. Për t'i dëshmuar vlerat e këtyre rapsodive autori sjell shumë shembuj, ku mirëfilli dëshmojnë vlerat e shumë këngëve si tekste, si realizime të ndryshme formësore e kuptimore, të ngritura mbi bazën e traditës së poezisë sonë gojore. Së këndejmi, secili që i

studion me kujdes dhe thellohet në qenësinë e tyre, përherë ka çka t'i shtojë asaj që është thënë më parë për to, ka mundësi t'i vështrojë e t'i interpretojë nga shumë aspekte, për arsye se si krijime të pasura letrare artistike, ato çdo herë ofrojnë mundësi të shumta për qasje të ndryshme varësisht prej kërkesave dhe pretendimeve shumë disiplinore edhe në fushën krahasimtare.

Ngushtë lidhur me *Rapsoditë* e botuara nga De Rada në vitin 1866, studiuesi Berisha e vështron dhe çështjen homerike. Në të vërtetë, disa autorë, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e jashtëzakonshme të traditës letrare gojore, i hartuan veprat e tyre të shkruara mbi bazën e modelit dhe strukturës së këngëve dhe i shpallën të traditës gojore, siç vepruan, fjala vjen, Zef Skiro (Plaku) dhe Gavril Dara i Riu. Dihet se çështjes homerike i priu dukuria e mistifikimit letrar, që mbërriti kulmin me Xhejms Makfersonin e Proper Merimenë.

Një kontribut të rëndësishëm studiuesi Berisha e jep në ndriçimin e elementeve të përbashkëta dhe dalluese të rrëfimit lirik dhe rrëfimit epik, që vërehen në disa elemente, fjala vjen, në dukurinë e formulësimeve, në modelet metrike sintaktike, në epitetet stolisë e, në imazhet poetike, në gjuhën etj.

Në këtë rrjedhë ai e vështron rëndësinë dhe funksionin e formulësimeve në epikën gojore shqiptare, veçmas te këngët e kreshnikëve. Kjo dukuri si bazë ka arritjen e një varg studiuesve të shquar, si A. Shmaus, Milman Parry, Albert Lordi etj. Berisha konstaton se formulësimet si teknika epike, nuk janë përherë të lidhura me një tekst apo me një qark të caktuar tematik të këngës, por ato mund të përdoren (nëse paraqitet situata ose detaji i njëjtë i veprimit) e të futen (inkuadrohen) në secilin tekst, para së gjithash kur krijohen këngë të reja ashtu siç theksojnë edhe komparatistë të tjerë të letërsisë gojore.

Autori ndriçon gjerësisht fillimet e njohjes së letërsisë gojore shqipe në gjuhën gjermane, ku përfshihet një traditë më se 150 vjeçare, që lidhet me kontributet e Ksylanderit, e Hahnit, Pedersenit, Lambertzit, Biondellit, Shtirit, Grimëve, Majerit, Jarnikut e të studiuesve të tjerë që ngjallën dhe ringjallën interesimin për letërsinë gojore shqipe.

Hulumtime të rëndësishme rreth epikës gojore

Vëmendja kryesore në këtë vepër i kushtohet pa dyshim epikës gojore shqiptare, e cila studiohet në krahasim me llojet e tjera letrare gojore shqiptare po dhe të traditave të tjera epike të Evropës Juglindore, duke filluar nga epet e lashta, në mënyrë të veçantë nga Iliada dhe Odiseja. Ai thekson se këngët kreshnike shqiptare përligjin pasurinë shpirtërore të shqiptarit e botës së tij dhe paraqesin një thesar të madh artistik. Në qenësinë e tyre këngët kreshnike përligjin një botë të lashtë legjendare, një botë e tërë mitologjike e kalorësiake, ku funksion të madh kanë qeniet mitike si orët, zanat dhe shtojzovallat. Këto këngë i cilëson organizimi shoqëror matriarkat. Pra, nëna udhëheq në familje.

Rreth rëndësisë dhe lashtësisë së këtyre këngëve Anton Nikë Berisha shkruan: “S’ka dyshim se shqiptarët janë autoktonë në shumë elemente të gjallimit, të veprimit e të organizimit shoqëror mbi bazën e së drejtës zakonore të veçantë si dhe të trashëgimisë së krijimtarisë materiale e shpirtërore, sidomos të gjuhës së tyre, e cila brenda gjuhëve të lashta indoevropiane ka mëvetësinë e vet. Të tillë janë dhe në krijimtarinë letrare gojore, në përralla e kallëzime, në gojëdhëna e në anekdota, në epikë dhe në lirikë, natyrisht bashkë me të gjitha ato përkime tematike motivore me krijimtaritë e popujve të Evropës Juglindore, si tipare të krijimtarive të popujve fqinjë, por edhe të popujve të tjerë, pa marrë parasysh hapësirën gjeografike, racën dhe përkatësinë fetare. Shqiptarët, si popull i lashtë kanë ruajtur edhe në krijimtarinë e tyre letrare gojore doke e zakone të lashta, rite pagane e qenie mitike, që janë tipike për një stad të hershëm të ekzistimit dhe të zhvillimit të njeriut. Së këndejmi edhe studimi i epikës gojore shqiptare brenda fenomenit epik evropian është me rëndësi të shumëfishtë, jo vetëm për ta bërë objekt trajtimi lashtësinë e epikave gojore të popujve që jetojnë në këtë trevë, për t’i trajtuar elementet e përbashkëta, por edhe për t’i parë ndryshimet që shprehen në strukturën tekstore si dhe në dukuritë jashtëtekstore të krijimeve epike dhe jo vetëm të tyre”.

Studiuesi Berisha e vështron dukurinë e ekzistimit të këngëtarëve brendës te shqiptarët për ta theksuar gjendjen e këngëve të shkurta dhe të gjata epike me të cilat qenë marrë një varg studiuesish, si Hahni A. Shmausi, Stavro Skendi, Dragutin Miçoviqi etj.

Ndër më të rëndësishmet Berisha veçon dhe e ndriçon krijimtarinë e Maksimialm Labertzit, i cili për vite me radhë u mor me lirikën, me epikën dhe me përrallën shqipe, jo vetëm duke i studiuar me një përkushtim, por edhe duke i përkthyer shumë sosh në gjuhën gjermane. Në këtë mënyrë ato u bënë të njohura në një rreth të gjerë.

Shqyrtim të veçantë Berisha u bënë dy llojeve të prozës gojore shqipe: përrallës dhe anekdotës, duke ndriçuar elemente të rëndësishme të tekstit të tyre.

Në mënyrë të veçantë e ndriçon poetikën e përrallës, njërit ndër krijimet më të rëndësishme të prozës gojore shqiptare, por dhe të popujve të tjerë, duke shfrytëzuar hulumtimet e ndryshme të disa studiuesve të shquar si vëllezërit Grim, Prop, Stros, Betelhajm, Lyti etj., ku e vështron përrallën përballë mitit dhe ëndrrës. Njëherit, i ndriçon format e shtjel-

limit të përrallës; strukturën kompozicionale, kontekstin poetologjik dhe raportin ndërmjet përrallës gojore dhe asaj të shkruar. Me përkujdesje të veçantë studiuesi Berisha i qaset edhe anekdotës si strukturë tekstore për t’u ndalur në poentën dhe mesazhin që bartin anekdotat në raport me kohën dhe vendin pa lënë anash as rrëfimtarin.

Në pjesën e tretë të librit autori i ndriçon një varg dukurish e mendimesh të autorëve të ndryshëm, shqiptarë e të huaj, rreth letërsisë gojore shqipe dhe rëndësisë së disa llojeve të saj, duke u nisur nga arbëreshi Vinçenc Dorsa, i cili i shfaqti një varg mendimesh për disa lloje të poezisë gojore arbëreshe, pastaj ato të Dhimitër Kamardës, të kontributit për natyrën dhe trajtat e këngëve të cilat i mbledhi dhe i botoi në “Sprovë gramatikore krahasuese mbi gjuhën shqipe” për të dalë te korrespondenca, kontributi dhe roli i Jernej Kpitarit për njohjen e këngëve popullore shqipe, po dhe në tendencat e Vuk Karaxhiqit dhe të numrit të madh të slavicistëve të tjerë që këmbëngulnin t’i zbehnin dhe mononin vlerat e letërsisë gojore shqiptare. Këtyre autorëve Berisha u kundërvihet me argumente të mbështetura në tekstet e krijimeve e të vlerave të tyre shprehëse poetike. Po përmend këtu qasjen konstruktive që Berisha u bënë të njohësve të mëdhenj të epikës gojore të shqiptarëve, si Mark Milani, i cili shquhet për qëndrimet dhe vlerësimet e tij të larta për këngët e shqiptarëve dhe për letërsinë gojore shqiptare në tërësi, Maksimilian Lambertzin për kontributin e tij në studimin e epikës, Matia Murkos dhe përmbledhjes së tij “Gjurmëve të epikës...”, me çështjen e parathënies së “Kangëve popullore gegnishte” të Vinçenc Prenushit, për ta përmbyllur me pikëpamjet mbi krahasimin ndërmjet dhjetërrokëshit shqiptar dhe dhjetërrokëshit serb veçanërisht te përkthimi i Dragutin Miçoviqit me ç’rast konstaton se paraqitja e këngëve kreshnike shqiptare në gjuhën serbe është shumë e dobët, “për të mos thënë e shëmtuar”. Megjithatë, sipas Berishës, në këtë përkthim dëshmohej dhe diçka e rëndësishme: vargu dhjetërrokësh i këngëve kreshnike shqipe, përkundër përpjekjeve të mëdha të Miçoviqit që ta bartë në gjuhën serbe sa më saktësisht, ka dalë, në një mënyrë ose në një tjetër, varg me natyrë tjetër. Pra, ky ndryshim i madh i natyrave të këtyre dy vargjeve e hedh poshtë teorinë tendencioze të disa studiuesve sllav se kinse vargu dhjetërrokësh serb na qenka huazuar nga shqiptarët!

Në këtë rrjedhë studiuesi trajton edhe çështje të natyrës krahasimtare, veçanërisht rreth origjinalite-

tit, ndikimeve dhe përkimeve të epikës gojore me epikën e shkruar në rrafshin e tematikës e të motiveve, veçanërisht pikëtakimet me narracionin shqip në raport me motivet ndërkombëtare të përrallave (migration story), gjithnjë duke i vënë përballë llojet e letërsisë sonë gojore me krijimtarinë gojore të popujve ballkanikë dhe më gjerë.


Pjesa e katërt, të cilën e emërton me “Interpretime:

Konkretësi e veçanti”, fillon me punimin “Hyji në këngët tona kreshnike”, ku autori ka vënë mendimin e Nënës Tereze: “Të besosh domethënë të jetosh [...] Besimi është e vetmja gjë që qenësisht është e jona”. Në këtë pjesë autori e vështron edhe funksionin e formulësimeve në “Halili merr Begzadën e Bardhë”, që i përket ciklit të këngëve të kreshnikëve dhe përbën njërin nga pjesët artistikisht më të ngritura të poezisë gojore shqipe në përgjithësi. Cikli shtrihet në pjesë të ndryshme të trojeve shqiptare, po ka bërë jetë më të gjatë e më intensive në pjesët veriore, në ato alpike – rurale. Autori e interpreton mirëfilli Këngën e Pal Golemit, që dëshmon për mbretërinë e simbolikës e të metaforave që ta përmbyllë me një krijim në kontekst të pasur poetik, pastaj tragjiken dhe kuptimësinë e flijimit të murosjes së gruas në ura e kështjella e me variante që i ndan koha prej një shekulli në të cilën pjesë autori vë theks të veçantë mbi raportin ndërmjet traditës sonë kombëtare dhe flijimit të gruas në këngët tona me temë të murimit të dhënies dhe të mbajtjes së besës, përkatësisht të betimit, duke kundruar tri aktet themelore të tragjikes dhe të së madhërishtes kur vdekja për të mirën e gjithmbarshme njerëzore ngadhënjën. Berisha e vështron edhe përmasën artistike të poezive gojore kushtuar Lidhjes së Prizrenit si dhe raportin realiteti artistik – realiteti konkret (historik). Pjesën e katërt të librit e përmbyll interpretimi i përrallës “Djali i Begut dhe Shërbëtori marrin gruen e Kacabashit”, ku përligjet “Loja e fjalëve”: *Kush dëgjoftë e tregoftë gur mermeri u mbaroftë dhe Kush dëgjoftë e mos tregoftë gur mermeri u mbaroftë*. Për këtë krijim të prozës gojore Berisha shkruan: “[...] strukturimi dhe funksionalizimi i elementeve të këtilla qenësore, sidomos i formulësimit kryesor, çelës, i kanë dhënë përrallës shqipe një tërësi dhe formë unike artistike, një dinamizëm e ritëm, një kuptimësi të veçantë, që kushtëzon një ndikim të dukshëm estetik të secilit që e dëgjon apo e lexon”.

Libri “Hyrje në historinë e letërsisë gojore shqipe” i Anton Nikë Berishës përmbyllet me vëzhgimet rreth përkimeve poetike të letërsisë së shkruar me letërsinë gojore shqipe në periudha të ndryshme në poezi, në prozë dhe në dramë, duke filluar nga fundi i shekullit XIX deri në Luftën e dytë botërore. Në mënyrë të veçantë fenomeni vëzhgohet në poezinë e Lasgush Poradecit, pastaj në veprën e I. Kadaresë “Ura me tri harqe” (Legjenda e flijimit-murosjes).

Të përmend këtu faktin se fenomenin e përkimeve poetike studiuesi Berisha e ka vështruar dhe në libra paraparakë si, fjala vjen, te vepra “Meshari” i Gjon Buzukut, te poezia e Pjetër Budit, e De Radës, e Gavril Darës, e Fishtës, proza e Azem Shkrelit etj.

Thellësia dhe rrafshi i ngritur i vështrimit të çështjeve dhe të veçantive të letërsisë gojore, ndriçimi i raportit me letërsinë e shkruar, metodologjia e qasjes, konceptet e qëndrueshme, saktësia e përdorimit të nocioneve si dhe dukuritë rreth ndryshimit dhe evoluimit të llojeve të krijimtarisë gojore në rrafshet diakroni - sinkroni, dëshmojnë për një punë studimore të mirëfilltë. Për këtë arsye ky libër është i rëndësishëm për të gjithë: për studentët, për profesorët që e japin si lëndë mësimi letërsinë gojore, për studiuesit e letërsisë gojore, por edhe për të gjithë ata që duan ta njohin mirëfilli këtë krijimtari, të thellohen në rrënjët e trashëgimisë sonë të pasur, që mbijetoi me shekuj pavarësisht stuhive e murrallëve. Merita kryesore u përket këngëtarëve dhe rrëfimtariëve, të cilët e krijuan dhe e përcollën gjatë shekujve për të arritur në forma të ndryshme edhe në ditët tona.



*Për vëllimin poetik “Shkreptimë e tjetër moti”
të Demir Gjergjit*

DUKE HETUAR LËVIZJET E SHPIRTIT

Nga Fatbardh Amursi (Rustemi)

Me poetin Demir Gjergji rastësisht u takuam në shtëpinë botuese “Onufri”. Në duar mbante librin e sapodalë nga shtypi: “Shkreptimë e tjetër moti”, një botim luksoz, të cilin ma dhuroi me autograf. U ndjeva “mik i librit”, sikurse stimuloheshim dikur në shkollë. Me asgjë tjetër, nuk mund të ndërtohen raporte miqësie, se sa me librin. “Leximi e rrit shpirtin”, -thotë një nga personazhet e Volterit. Do të stonosh, nëse ti thua: mik i veturës, apo i modës, pale i një pushtetari, që s’ia kam uruar kurrë vetes. Mund të mos jesh as mik e as shok me autorin, por ndjehesh i tillë me krijimtarinë e tij, gjë që na ndodh, sikurse dhe e anasjelltë. Prej asaj dite jam në shoqërinë e librit të Demir Gjergjit, me të cilin jap e marrë, duke qenë kështu biseda me e gjatë, që mund të kem bërë ndonjëherë me poetin, i cili e ka nisur rrugëtimin poetik, qysh prej vitit 1970, si koha më e keqe për të bërë art. Fëshfërima e fletëve të librit më hedhin në motin e shkuar, njohur si koha e realizmit socialist. Prej andej ka rrjedhur një gjysmë shekulli krijimtari. Një investim shpirtëror mbresëlënëse, jo vetëm i tij.

Poetët me të kaluar socialiste, flas për të talentuarit, i ndjek me pa të drejtë një paragjykim, ku fajet e kohës ia hedhin njëri-tjetrit si mëkat, sikur të mos mjaftonin njollosjet e recensentëve, redaktorëve, aparatçikëve apo e ekspertëve të akt-akuzave. Balta, që Dritëroi, solli në Lidhjen e Shkrimtarëve në një “trastë leshi

ndën gunë”, s’paska të shterur. Në historinë e artit shqiptar, nuk është sakrifikuar aq shumë nga vetja, se sa poetët dhe artistët e realizmit socialistë, ku patosi përngjante më vullkanin, ndërsa fatet njerëzore me hirin e tij. “Kam kërkuar portë të madhe për të hyrë tek kjo botë.”-shkruan poeti, duke na sjell në mend harkun e triumfit, që për poetët e asaj kohë kishte imazhin e kularit. Kupola e qiellit, e kishës apo e xhamisë, e bunkerit, helmetës së udhëtarit dhe në fund: borsalino e udhëheqësve. Mjafton “letërsia e burgut”, (poezia ishte shkaku i burgosjes së Visar Zhitit), si dëshmi e martirizimit të atij brezi, i cili për të mbajtur gjallë “shpirtin poetik”, në një regjim që ta merrte atë, falë muzës: fryma poetike shtegtoi tek lexuesi, si një energji e brendshme në një shoqëri me të drejta shterpe. Këtu duhet kërkuar arsyeja, që në kohë prangash, nuk u ndjemë të burgosur. (“E shenja frymë mëkatet ndez,/Parajsën zbraz e ferrin mbush,/Dhe bëhen bashkë virtyt e ves,/Të ngrihen flakë, të prehen prush.”) Gjithkush kishte telashtet e veta, përjashtoj të preferuarit e autoriteteve, që ia hapnin rrugën vetes duke ia mbyllur të tjerëve. Zor se përsëritet ajo kohë, kur ndaj çdo botimi apo ekspozimi, duke mos përjashtuar as dorëshkrimet, të projektohej një vëmendje mbikëqyrëse me frikën se mos po bëhej gabimi, ku pritshmëritë e lexuesit për “një gjë ndryshe” përmbusheshin veçse midis rreshtave. E pathëna, ishte



si një komunikim me orakujt. Hermetizmi i dënueshëm si herezi, tani është kthyer në mani fshehesh pa të fshehtë, përngjashëm me atë që fsheh diçka dhe ngaqë s’i kujtohet ku e ka lënë e humbet përgjithnjë. Tek e sotmja ndodh rëndom që, botimin e librit të mos e vërë re askush. Dikur të merrte më qafë censura, ndërsa tani të skualifikon “komploti i heshtjes”. Nëse në grepin e censurës binin “peshqit e mëdhenj”, në rrjetën e medias së lirë, paketohej sardet. “Hyr në moshën time, shko në kohën tjetër,/Fillo të më rrëfesh për lotin dhe për ndjenjën.”-i drejtohet poeti, në mbyllje të librit, një vogëlushi, që të bëhet pelegrin i shpirtit poetik, ofruar për së shumti, si një tempull pa klerikë e ciceronë. “Nëse s’ke dritë për t’u zgjuar,/Në s’gjen udhë për t’u nisur,/Merre fatin tim ndër duar!/Mbroje si fëmijë të mitur.”-shkruan autori në poezinë “Pasjetë”, duke besuar se ai do t’i duhet dikujt, që i lind nevoja për udhërrëfimin e autorit. Duke u zgjatur rruga e njeriut për tek miti, bashkudhëtari i poetit duhet të ketë këllqe që ta ndjekë, pasi shumica e rrugës kalon nga qielli dhe në territore, ku shtigjet janë të zëna. “Mirënjohje, zonjëz e hijshme,/Që hodhe parfume enigme.../Si ajër më shkoje kaq pranë!” Shko e kape gërshtetëzën e gjolit!

Nëse moti i shkuar ishte i mbushur me gjëmime e alarme dhe delli poetik reagonte me patos, tek ky i sotmi kemi shkreptima, që shëmbëllojnë me shkreptjen e blicit. Janë qetësuar stuhitë dhe dallgët janë fashitur, por inatet vlojnë. Dikur kërkohej nerv, ritëm, angazhim, duke u shqetësuar për paqen në botë, tani mjafton të sigurosh paqe brenda vetes, duke hetuar lëvizjet e shpirtit dhe kazerna u kthye në manastir. Përkundrejt të tjerëve, poetët e ardhur nga socializmi, mes rrëmujës e rrëmetit, u shijon qetësia, jo si vegjetues, por të përfshirë në një Lëvizje Broviane, ku s’rreshtin kërkimet për art. Duke rrezikuar për lirinë, se kush në të vetën, poetët e së shkuarës ndjehen në një mbretëri, ku s’janë thjesht përfutues, por dhe kontributorë tek e sotmja. Gjysmë shekulli i lënë pas të duket, sikur e jeton në një ditë të vetme. Volter: “Unë them se kombet...janë marrë gjatë shekujve vetëm me çastin e tanishëm që rrjedh.”, ku e tashmja e momentit reflekton të shkuarën, jo si fosile, por si shprehje e identitetit. Një histori e zhveshur nga çastet e mëdha nuk ia vlen të jetohet. “Asnjë sekondë s’u ngushtua nata,/Asnjë minutë s’u zgjerua dita./Ndonëse të tjera përmasa,/Kërkoje nga çastet e mija.”-shkruan poeti Gjergji në poezinë “Koha”, nën presionin e dilemës, me naze kundërshtie: “Retë shthuren shi,/Zjarret dergjen hi”. Tjetërsimi na shpërblen me larmi. “Fundit i Fundit, Fundit Fundin prej fundit e ndau më dysh... Fillimi i Fillimit, Fillimit fillimin prej Fillimit ia nis.” Zebra bardhezi nuk ka varfëri ngjyrash, edhe nëse krahasohet me mozaikun plotë ngjyra të palloit.

Nëse do kërkoja një të veçantë të “unit poetik”, do e shihja atë në shfaqjen e njëjësit në shumës, ku pavetori, mund të marrë dhe emrin tënd në kërkim të shpirtit binjak. Unë+ti=dy male, dy ishuj, dy limane, dy brigje, dy gjendje, dy pamje, dy breza, dy të dashuruar, dy epoka, shtoji dhe dyzimin e vetes nga monizmi në



pluralizëm. “Kur ndjem keq/Dhe vetes këmbëzën jam gati t’ia heq./Demir Gjergji më gjen, tek vjen prej mëkatit/I lodhur nga bëmat e natës së shtratit./ (Demiri, që veç për dashurinë tradhtoi/ Dhe spiun i regjur i vetvetes qëlloi.) ...Kështu,/sa herë ndjem keq./Gishtin nga këmbëza Demir ma heq.” Nuk është e lehtë të përballesh me veten, pasi ke vetëm dy alternativa: o të dalësh nga vetja, o të ngrihesh mbi veten, të cilat përkojnë me pragmatizmin dhe idealizmin. Shpirtërorët preferojnë qiellin, për të përgatitur veten dhe ata që u shkojnë pas, për në gjyqin e fundit. “Duhet tjetërkush të bëhesh,/Për të njohur të vërtetën tënde.” shkruan poeti duke hetuar shtegtimin e shqisave, përngjashëm me antenat, që ia përcjellin sinjalin njëra pas tjetrës. “Në betejë me të keqen,/Panë, ç’ panë i hodhën armët,/Nisën me mundim tërheqjen,/Trup e frymë përmbys nga flakët./Ballëpërballë s’i mposhtëm dot,/Kurthe, prita, dinakëri./Ndeshja ishte krejt e kot, Me këtë fuqilubi” Mundja e së keqes, ku protagonist janë Eva dhe Adami, ku “oqeani është i klonuar me qiell”, ti si lexues endesh në realitete, që kanë për udhërrëfyes poetin. Në këtë dyluftim të dashuruarish, më i sinqertë po duket Don Kishoti në vajtimin e Dylqinjës: “Hyj e dal në jetë,/Nuk ta gjej dot vendin./Marr me not një det,/Që nuk ia di emrin./Futem nëpër gjumë./Përplasem me zgjimin./Kapërcej një lumë,/Që s’ia di burimin.” Oqeani i qetë, nuk ka ndonjë dallim nga Atlantiku, po aq madhështor dhe i frikshëm, në mos në brigjet e oqeanit Paqësor zjarri i luftërave nuk rresht, por, në udhëtimin e Magelanit, qëlloi të ishte i qetë dhe eksploratori e pagëzoi, si sinonim të qetësisë olimpike. Subjektivizmi i tij, buron nga një e vërtetë e rastësishme, edhe pse nuk i përgjigjet së vërtetës, oqeani nuk është i qetë, as paqësor, por, përjetimi i Magelanit u kthye në perceptim. Për ta ilustruar mendimi po i referohem poezisë “Natyrë e qetë”: “Deti dremiste!/Kaikja në breg,/Nuk mundej të tundej./Ta vinte në gjumë ëndrrën e vet!” Jam duke thënë se kush eksploron botën, qoftë kjo dhe poetike, duke përfshirë dhe mbretërinë e Platonit, zbuluesi ka privilegjin e emërimit, kështu që çdo kontestim i mundshëm, duhet të respektojë sinjalistikën e poetit. “Asgjë, ngado që ta kthesh kokën./Asgjë nga lart, asgjë nga poshtë!/Të duket se je ti për botën,/E vetmja pikë, i vetmi bosht!/E marr me mend se kjo më ndodh:/Sepse dhe ti, atje ku je,/Kthen kokën anash, lart e poshtë./Dhe s’ndjen asgjë që nuk më sheh!” Një dashuri e humbur ka këtë epilog: “Mbyllma shpirtin brenda psherëtimës.”

Ndoshta po lë shkas që, dikush t’ më thotë: të paska mbetur zbukurimi i realiteti qysh nga koha e realizmit socialist, ndaj i bën dredha qëndrimin realist, i cili dikur ndëshkohej për “nxirje të realitetit”, kur sot sharja është kthyer në hobi. (“Plasi bombën”-thuhet rëndom për analistë dhe politikanë, ku “retë me pantallona” i shesin për “mbushje atomike”. S’ka më bukur, se sa gëzimin e tjetrit ta shoqërosh me shpërthimin e një shampanje. Nuk jam duke bërë reklamë për pijet me gaz.) Kam alergji për aksh persona, që dikur merreshin me “kufizimet ideore”, duke më përngjarë me “sendet e gjetura”, që dikur policia i ekspozonte në qytet, duke fshehur të arrestuarit. Nuk është njësoj si të hedhësh dorashkën e bejlegut dhe të tundësh shaminë e përshëndetjes. Nëse e besojmë Floberin çka ai predikon në romanin “Edukim i ndjenjave”, kam bindjen se nuk mund të pretendohet “përsosja morale” e një shoqërie, nëse ti vetë nuk kultivohesh. “Rasti për t’i bërë keq tjetrit gjendet njëqind herë në ditë dhe për t’i bërë mirë një herë në vit.”-do e citoja për të tretën herë Volterin, i cili e shkoi jetën në arrati, ngaqë shigjetat e satirës godisnin mbretër dhe perandor. Nëse më ka mbetur një ndjenjë respekti për Marks, kujtoj sjelljen e tij ndaj Hajnes, që kur ishte i revoltuar linte të shoqen, ta priste. “Në zemrën që digjet, nuk hyhet me çizme, por me ledhatime.”-këshillon Majakovski, edhe pse vargun e quante “bombë e flamur”. Të hetosh lëvizjet e shpirtit, nuk është njësoj, si të ndjekësh gjurmët e krimin.

Romani *ALM* i Ahmet Jasharit

NJË ROMAN “PUZZLE” QË VË NË LOJË MISTER-ET DHE IRONITË E JETËS

Nga Arben Veselaj

Romani *ALM* i Ahmet Jasharit është një nga të rrallët që shtjellon dramën morale dhe ekzistenciale të njeriut të sotëm; zhbirimet psikologjike dhe pasojat e një jete të mbyllur; përpjekjet e njerëzve të thjeshtë që luftojnë për t’u mbijetuar kohëve të këqija. *ALM* paraqet tipin e romanit psikologjik, apo më mirë të thuhet është një kronikë autentike rrëfimi, një formë personale përshkrimi e përsiatjeje, që lidhet me “shpikjen” e një makine që lexon mendimet e të tjerëve.

Zbulimi i botëve, i paragjykimeve, i mistereve dhe i prapaskenave në mes të personazheve që kanë lidhje familjare, miqësore, e të tjera, në fakt është trilli i këtij romani që të mban frymën gjatë leximit. Autori ka arritur që përmes një nënteksti të fortë dhe me një sërë situatash simbolike të na ofrojë një prozë që depërton thellë në plagët shpirtërore të njerëzve të zakonshëm, përvojat e të cilëve, jo rrallë, ngjajnë me ato të tragjedyve eskiliane.

Përmes një empirizmi psikologjik ai na rrëfen përvojat e personazheve, duke shprehur papajtueshmëri me një rend të përmbysur vlerash: me moralin e dyfishtë, paragjykimin, tradhtinë, dhe, në fund, me vrasjen. Në tërësinë e tij ky roman padyshim se vë në thumb të kritikës të gjitha këto fenomene që e stërkeqin shëndetin e njeriut dhe rrjedhimisht edhe shëndetin e shoqërisë, apo atë që filozofi gjerman, Erich Fromm, e quante “sëmundje e kulturës”.

Vetë titulli *ALM* duhet të kuptohet si figurë e cila e ka shpjeguesin e botës që ndërtohet në këtë roman: A=Aparati, L=Lexon, M=Mendimet. Pra, një mjet i shpikur nga një kureshtar i kësobotshëm, përmes të cilit zbulohen të fshehtat brenda mendimeve të të tjerëve. Rrëfenjat e personazheve të këtij libri lidhen me fenomenet universale të shoqërisë, por konotacionin dhe shtrirjen në kohë dhe hapësirë e kanë te jeta e një shoqërie të caktuar që gjallon (apo ka gjalluar) në kushtet e robërisë, ndjekjes, burgosjes, luftës etj.

ALM ka një prirje për t’i parë gjërat më të padukshme dhe për të depërtuar në thelbin e intimes dhe kështu për të krijuar formatin kompozicional të një trilleri psikologjik ku bashkohen shumë rebuse dhe në fund na shpërfaqet një roman i strukturuar mjeshtërisht.

Personazhet e këtij romani gjelojnë brenda një bote ku të gjithë janë dyshues dhe të dyshuar; përmes një monologu të brendshëm ata na zbulojnë vetëdijet e tyre të lënduara dhe të zhytura thellë në dilemat më të mëdha morale dhe ekzistenciale. Bota ku rropaten personazhet - e cila botë nganjëherë na duket shumë e largët, në fakt është pikërisht bota jonë, shoqëria jonë, njeriu ynë - ndoshta një arketip i atij njeriu që ka një vizion të kundërvëntë me botën që njohim.

Ai që na prin në rrëfenjën e këtij romani (psikologu) mbase mund të kuptohet edhe si një kronist i cili,

në mënyrë të pavetëdjshme e shkruan kronikën e urrejtjes, të dashurisë, të gënjeshtërs, të paragjykimit, të dilemave, të maktheve, të përbetimeve të fshehta etj.

Ky roman, si rrallë ndonjë tjetër, përmes parabolash dhe kuptimesh të bartura thyen shumë klishe romanore që njohim, ndërsa rreket të na paraqes një atmosferë ndryshe të shoqërisë sonë, e cila nuk ka as kohë (kur ndodh) dhe as adresë (ku ndodh). Ai ka elemente të një “proze elegante”, nganjëherë merr edhe karakterin e një romani “puzzle” ku përmes kuptimeve të fshehura na shfaqet një lloj loje e çuditshme që brenda fsheh krejt ironinë e jetës.

ALM është një roman, ndër të rrallët e prozës tonë, që merret me një psikanalizë kaq të thellë të personazheve. Si i tillë ky roman mbase edhe mund t’u shërbejë lexuesve si psikoterapi për shërimin e gulçeve të shpirtit; përmes mesazhit humanist ai është vërtetë inspirues për kapërcimin e rubikonit moral dhe ekzistencial.

Ahmet Jashari



ALM

roman



RA NJË MJEGULL E MADHE

Nga Rexhep Ferri

1.

Pak më andej, më andej, më afër.
Deri te Iliri!
Nganjëherë quheshim Albanë.
Nganjëherë Shqiptarë!
Në anën tjetër të detit dy romakë.
Vëllezër binjakë.
Të ushqyer me qumësht ulkonje.
Kur u rritën u bënë trima të famshëm.
Mendonin se në anën tonë kishte më shumë diell e hapësirë.
Pas një loje damë me hënë plasi lufta.
Nuk kishim rrugë tjetër!
E kishim vetëm këtë mundësi!
E kishim të vërtetën ta pranonim si të vërtetë.
As pyetje e as përgjigje në gjuhën e nënës nuk kishim.
Gorillat e patriotizmit mashtrues vrapuan pas hajnisë e pas plaçkitjeve. Mendja u rrinte vetëm aty.
Në Shkodrën e mbretërve, mbretin tim e zunë rob.
Mbretëresha nga pikëllimi bëri vetëvrasje.
Lufta mori fytyrë të legjendës.
Rreziku ishte fuqi.
Lufta e fundit çka të do syri.
Ne, ilirët, albanët, shqiptarët u mundëm keq.
Në jug helenët nuk pritën sekondat.
Çdo ditë nga një luftë.
Çelësi i jetës ra në duart e armikut famëkeq.
Muret e shumë kalave u rrënuan.
Nuk ishte e lehtë për ta kuptuar, prandaj jam pak i egër.
Është pak vonë për të qenë në Çamëri e në Kosovë.
Ajo që është më e çuditshme, me teke personale shkon edhe më larg.

Zoti nuk pa asgjë...
Vetëm kaq di!
Askush nuk na njeh mirë.
Nëse nuk e kemi ditur më parë, e dijeni tani.

2.

Për hir të historisë që e lamë në gjumë, s'na besohet.
Kurrë nuk na bëhet vonë.
Vetëm kaq dimë.
Edhe pse shumë gjëra mund të ndryshojnë e ardhmja nuk ofron mundësi.
Ra një mjegull e madhe nga majat e Bjeshkëve të Nemuna deri poshtë te rrjedhat e lumenjve.
Prandaj ende kemi shumë legjenda...
Gjarpri i gdhendur në gur gjithmonë na pret te Dera e Madhe e hyrjes në kullë.
Nuk kam ide tjetër për portën e kullës.
As për ballin e portave të kullave, as për gjarprin e shtëpisë.
Jeta është art.
Kur nga deti na vjen haberi.
Aty e kam takuar gjarprin e shtëpisë që shoqërohej me perënditë.
Bashkë me perënditë e dy horizonteve.
Me helme e kundërhelme.
Si ujërat e lumenjve të detit të oqeanit.
Me emrin e fshehtë të kohës.
Të kohës që e ka edhe një emër tjetër të fshehtë.
Një, dy, tre...
Fluturimi në afërsi nuk është rrezik.
Duhet të jemi më shumë se tre.
Të përpiqemi të shpëtojmë.

3.

Ku do të shkojmë?...
Të kemi kujdes!
Më mirë është të vazhdojmë të jetojmë.
Nuk ka vlerë tjetër që mund t'i themi se e ka shkëlqimin e vlerës.
Koha kur ndodh gjithçka seriozisht se prishet.
Kur s'kanë asgjë për të thënë, t'i lëmë njerëzit t'i marrin përgjegjësitë e veta.
Disa vite para historisë, në Egjiptin e Lashtë koha ndahej në tri stinë:
“Në atë të përmbykses, në atë të mbjellave, në atë korrave!”
Hollësi tjera nuk ka.
Diçka më thotë: Ky është momenti!
Për të vazhduar del dikush e thotë: As që dua të di!
Një dritare e pabesueshme qeshi.
Çmimi është i lartë.
Unë e pashë edhe fundin.
Çdo gjë e ka kohën e vet.
Prandaj e ndeza një qiri.
Më pëlqen të besoj.
Ëndrra ime shkon e prek qiellin.
Më tepër se ç'duhet e kam humbur fillimin për kohën që ka ndryshuar...

4.

Jetës për ta ruajtur qetësinë i duhet rinjohja.
Shkollë emocionale.
Edhe pse ajo që shprehet në imagjinatë nuk ndodh në jetë.
Për ta anashkaluar vetëshkatërrimin, truri i njeriut nuk e kupton dhe nuk e pranon psenë si betejë e humbur.
Si gjendje konflikti, për të bërë jetë normale nuk ia vlen të presim.
Shikoje punën tënde!
Pakkush di se kush vjen sonte për darkë.
Ajo që na bën njerëz është e lidhur ngusht me një frikë të madhe.
Zemra e errësuar kthehet aty ku ishte.
Nuk ka qenë e kuptueshme për të gjithë.
Besoni ose jo, unë jam çka armiku im nuk ka qenë.
Nata e ndezur është shumë e thjeshtë.
Na vë në gjumë të gjithëve.
Për një ëndërr të humbur...
Gjithçka fillon diku.
Në gjininë e artit është thirrje.
Afrohu të lutem!
Për fatin tonë të keq.
As më shumë e as më pak.
Gjueti shtrigash!
Dhe xhungël e interesave personale të patriotëve politikë.
Fundi i shekullit.
Koha e së ardhmes.
E tashmja ime.
Çmenduri që frymëzon
Me kënd.
Me askënd.
Kam humbur rrugën.
E vështirë të përgjigjem.
Më shumë se sa që duhet i mora vesh të gjitha.
S'pres përgjigje.
Propozoj kohë shtesë.
Festa është festë.
Dita ditë.
Nata hënë.
Mos kërkoni hollësira.
Sot si dje.
Nesër si nesër.



Nga brezi në brez liria e çmuar sa jeta.
E parakohshme për ta ruajtur.
Duke kaluar rrugën e duke marrë me veti gurët kilo-
metrik të rrugës e parakohshme për ta ruajtur.
Dhe duke analizuar kohën, vjen një proces i krijimit të
një rrethi katror.
Gjërat tjera janë të një kohe tjetër.
Duke afruar pamje nga historia e harruar.

5.

Pas luftës së prostitutave politike, shqiptarhanja nuk e
pa sa e poshtëroi veten.
Ndjenjë e pakuptueshme!
E çuditshme!
Më pak se diçka e besueshme.
Me kërkime e verbëri.
Ky peizazh ka lidhje me ëndrrat që kurrë nuk pikturo-
hen ashtu siç i shohim.
Tek unë as çmenduria kurrë nuk është e njëjtë.
Miti i makinës kalon imagjinatën e njeriut.
Nuk bëhet fjalë sa po rrezikojmë.
Me fat të keq nga ana psikologjike edhe nga shëndeti
mendor nuk po dimë se çka të bëjmë me vetveten.
E vërteta dhe harresa po na mësojnë të shohim më
lart.
Çdo gjë nuk është e përjetshme.
Në metafizikë, me shpresë, për fat të mirë të gjithë
shohim ëndrra.
Zbritja në hënë, në kohën e territ, është miti i territ...

6.

Qysh në barkun e nënës i kam dëgjuar topat e luftës.
Në Kukësin e vendlindjes, në Prefekturën e Kosovës
deri në ditët tona ajo kohë quhet Koha e Topave.
Nga terri mbi një kodër, në këtë botë, për të bërë një
jetë normale, në zemrën time zot kush fiton e kush
humb.
Për të vazhduar jetën në ecje në kohë, jemi njerëz.
Vdesim nga mungesa e oksigjenit.
Për të qeshur e për të qarë ende ka kohë...
Zemër, vazhdo, vazhdo!
Dua një përgjigje.
Asgjë nuk është siç ka qenë.
Libri nga një i vdekur ende krijon shqetësime gjumi.
Profesor si e njohët djallin?
Siç të njoha ty!
Studtesha A, qeshi.
Nuk e pranoj këtë histori.
O zot i lumi zot...
Pastroje jetën prej varfërisë shpirtërore.
Populli e kupton dhe e njeh varfërinë.
Do të mbijeton.
U lodha duke pritur liria të jetë personazh real.
Është shumë terr për ta parë se më buzëqesh liria e
çmuar sa jeta

7.

Kush po flet për fytyrën!
Sa ka mundësi e kemi harruar?
Në eklips të hënës dikush ëndrrën e ka një zbavitje.
Nuk po tallem.
Sa mirë e thashë.
E mposhta frikën, terrin.
Ajo kohë, sa e tmerrshme ka qenë.
E kam me gjithë mend.
Jam njeri.
Tani e kuptoj çka po bëj.
Duhet ta them të vërtetën.
Koha rrëzon mure.
Rrënon ura.
Varros njerëz.
Aty e atëherë kur njeriu ëndërron lirinë.
Po e pse?!
Janë bërë shumë pyetje.
Shikoni kush ka ardhur.
Nuk ju lëndova.
Nga terri jemi përtej kufijve, as në tokë e as në qiell.

2021

GRIMCA

Tregim Mehmet Elezi



Qe ora katër e agut, kur i shqipëroi katër vargjet e fundit. Bëri krak dera. Doli një hije. Ai njohu
profilin e zotit të Skëterrës. Po më le?, i tha. Ajri në fjetën e vogël u thith. Ai s’po merrte dot frymë.
Nuk po të lë, tha zoti i Skëterrës, duke tërhequr derën pas vetes. Mbaruam bashkë, po dal.

Iu kujtua Fishta. Fishta kish parë shkrimin për *Lahutën* te *Hylli i Dritës*, kish këqyrë autorin. A
kjo grimcë e ka shkruë?, kish thënë dhe i kishin zditur sytë e zinj. Pashko Gjeçi gjithmonë kish
qenë imcak. Sa një rrum. Tashti edhe më i imët. Mishin ia kish ngrënë biruca e të burgosurit politik.
Ani pse nuk qe marrë kurrë me politikë. Gjakun ia kishin pirë mushkojat në kënetën e Maliqit, kur
punonte si i burgosur politik. Ani pse nuk qe marrë kurrë me politikë. Eshtrat ia kishin tkurrur
vitet. Vitet i kish dyfishuar vetë, një vit e kish bërë dy. Duke shqipëruar kryevepra të botës.

A kjo grimcë e ka shkruë?, kish thënë Fishta. Dhe e kish rrokur me të dy krahët. Zoti i *Lahutës*
kishte ikur moti. Tashti edhe zoti i *Ferrit*.

E thërrasin në një zyrë.

-Ku banon?

-Te Shallvaret.

-Ke shtëpi?

-Jetoj në bodrum.

-Do të të japim banesë të re.

-Faleminderit.

-Brenda javës të vjen autorizimi. Ka urdhëruar i Madhi, e kupton?

I Madhi është Ai, kush tjetër. I Madhi është Dantja, zoti i Skëterrës. I Purgatorit dhe i Parajsës.
Nuk po të lë, tha. Nuk më paska lënë.

Autorizimi vonohet. Kalojnë tri javë. Kalojnë tre muaj. I ndërmendet kënga e moçme: *Shkuen
tri javë e shkuen tri vjet/ Pushka e Lilës s’po kërcet!*

Një hije në derë. Nuk të pëlqeu apartamenti?

Ai habitet.

-S’kam marrë apartament.

-Qysh nuk paske marrë? Ka urdhëruar i Madhi.

Pas dy javësh, ndjesë, një ngatërresë e vogël. Autorizimi për Pashko Gjeçin i ka shkuar Pashko
Gecit. Ai ka hyrë në apartamentin tuaj. Është urdhëruar ta lirojë menjëherë.

Pashko Gjeçi zverdhet. Pashko Geci, mësuesi im. Ma mësoi greqishten e vjetër. Blinte libra për
mua. M’i linte nën bankë, mos me u fye unë. Grimcani zvogëlohet edhe më. I dridhen këmbët.
Mund ta mbledhësh në grusht.

-Nuk. Ai ka hyrë në apartamentin e... tij. Edhe ai ishte pa shtëpi, si unë.

Fundja s’jam aq keq, mendon. Në këtë bodrum s’është kushedi vapë. As kushedi ftohtë nuk
është. Është si galeri miniere, na mbron dheu.

Njeriu i zyrave largohet. Hyn zoti i *Ferrit*, Dantja. Nën sqetull një libër të trashë. Deri matanë
qiellit, të trashë. Vajulurimë. Nuk qenka libër. Nën sqetullën e burrit është *Komedia Hyjnore*. Vetë
matanëbota.

Pashko Gjeçi mpaket.

-Ti je këtu, thotë zoti i Skëterrës. *Ata* do të jenë atje. Duke u përpëlitur nëpër nëntë rrathët e
përtejbotës, që kam nën sqetull.

E kam ditur se vjen, thotë Pashko Gjeçi. E ndjeva në katër të mëngjezit, kur përktheva katër
vargjet e mbrame të *Ferrit*.

*hipëm, i pari ai e unë mbas tij
nga gropa pashë - vegim i mrekullueshëm -
stolitë që veshin qiellin pa kufi*

e dolëm prap me pa yjtë e vezllueshëm.

Zotnia i *Ferrit* shtanget. Po mendoj si tingëllojnë më bukur: siç i kam shkruar unë apo siç i ke
shqipëruar ti?

NUK KA PSHERËTIMA VETËM NË NJË URË

Tregim nga Delvina Kerluku

Më kishte marri malli për një frymëmarrje nga ato që kisha përjetuar rrallë. Prandaj mora thellë, ashtu siç merret kur i ke bërë edhe hapat e fundit në një maratonë të gjatë. E lodhur nga ecja me biçikletë, e cila jo gjithmonë të fal kënaqësi, u ndala përpara njëres nga urat e shumta që ka kryeqyteti. Duhet pranuar se lodhjen më të madhe ma shkaktonte shoferët e pakujdesshëm, të cilët thuajse ishin vënë në garë se cili do bëjë më tepër shkelje kundërvajtëse. E qetë, hodha vështrimin larg, mbi syprinën e ujit të dallgëzuar, të cilin desha ta



pyes njëherë: po ti ç'pate që je shqetësuar? Por e lash, duke qenë e bindur se edhe ai do ketë një hall, meqë është ngrysur fare. Një barkëz brazdonte ujërat e gjirit drejt grykëderdhjes së lumit në detin Egje. Dallgët e mëdha rrihnin bregun e thërrmuar, por jo edhe me aq mlllef. Rrahje tipike lumore, që ndryshon shumë nga rrahjet e dallgëve të liqenit, e sidomos atyre të detit. Edhe pse kisha lindur larg këtij lumi, pamja e dallgëve të shkumuara dhe sipërfaqja ujore që tretej në horizont, më jepte kënaqësi.

Peshkatari, pak i lodhur, pak i zhgënjyer nga **bereqeti i pakët**, po ankonte barkën e vjetër në një si gji të sajuar të bregut. Ecte duke lënë një vazhdë shkume. Edhe pse nga kjo largësi nuk mund t'i shihte, i mori me mend pulëbardhat që klithnin e përplasnin krahët pa pushim në qiellin pak a shumë të mbuluar me re.

Retë kishin mbuluar diellin dhe grinë e qiellit. As qiellit nuk i shkonte kjo grija e theksuar. Nëpër mbretërinë e tij notonin grumbuj të lehtë resh të lara argjend. Ujërat blu të errëta shndrisnin vende-vende.

Mendova me gëzim shëtitjen prej një ore e gjysmë, që po bëja përgjatë bulevardit, duke thithur ajrin e freskët, por edhe të ndotur, e duke dëgjuar zhurmën e valëve. Kjo aromë pranvere, përmes erës më solli ndërmend urën me dërrasa, në qytetin e poezisë, në Strigar, ku kisha marrë frymëzime poetike, madje edhe frymëzime jete. Sa qëndroja në këtë qytet urash, gati se u binda për magjinë e tij dhe për famën e përhapur se në të muzat nuk kursehen për t'iu dorëzuar poetëve. Thash: po nuk e ka marrë kot epititet Qyteti i poezisë! Kësaj radhe era, bashkë me freskinë, më hodhi edhe mbi krahët e lehtë të nostalgjisë. Kështu, e kredhur në krahët e kujtimeve, m'u duk se ndjeva një heshtje të rëndë prapa shpine. Dhe dëshpërimi më kaploi fët e fët. U ktheva menjëherë për të parë, nëse është ai vezullim që më shfaqej aq shpesh. Ishte Ai, aty. I pa lëvizshëm. Me atë pamjen e tij të përsëritshme. A thua do të më tradhtonte tani kjo imagjinatë, si shumë ditë më parë? Tek ndihesha e shkretuar, e braktisur, e zhytur në pasiguri! Bëra disa hapa drejt stolit, poshtë urës, ndërsa biçikletën e "prangosa", mbi urë, aty ku ishin mbyllur me kyç dashuritë e mëdha, siç kishin dëshirë t'i quajnë aktorët dhe autorët e tyre. Të vërtetën, besoj, nuk e dinë as vetë ata. Natyrisht, ndryja ishe në mënyrë simbolike, se ku ndryhet dashuria!? Hapa kanaçen me lëng, duke e pirë me një gllënkë. Çfarë etje paskam pasur!? Si e marrosur nisa ta kontrolloj bllokun e shënimeve, duke kërkuar poezinë "Pëshpëritje mbi urë", të një poeti të njohur. Pija e ftohtë, duke rrjedhur nëpër rropullitë e mia, më shkaktoi ndjesi kënaqësie. Mos i humb shpresat, i thash vetes. Ëndrra e keqe do të davaritet. Kështu ndodh shpesh. I kisha dërguar tri letra Zhanit. Atij, Zhanit tim, de. Të çiltra, të prekshme, duke i hapur zemrën. I kisha kërkuar falje për ndonjë gabim që mund ta kisha bërë. I qesh betuar se do të bëja çdo gjë për t'ia shpërblyer me njëqind të mira, gabimin e vetëm që mund ta kisha bërë. I kujtoja kohën e gjatë të vetëmohimit, të ndershmërisë së plotë, siç e provonte edhe fakti që tani, me të ikjen e tij, kisha ngelur në rrugë, vetëm me biçikletën për dore.

Zhani, vërtet është zemërgjerë. Mund të ishte edhe i ashpër, po ta lypte nevoja. Por, po ashtu, shpirtmadh, si poet, të cilin gjithmonë e citoja. Fjalën e tij në çdo çast do ta interpretoja në Pallatin Kombëtar të Kulturës apo në Vila Aleksandria. Por, jo veç fjalën, por edhe atë vetë. Ai nuk ishte i imi, siç më kish thënë më herët, tek mbante lotët e mi në duart që kishin shpërndarë dashuri në çdo cep të Atdheut. Nuk e kuptoja atë në takimet e fundit bashkë... Kisha mbetur me një vegim. Një ëndërr e tmerrshme më shoqëronte, herë pas here. Më ndiqte për të rrëzuar ngjitjet e mia, për të përmbysur arritjet.. Në këto mendime, lot të rënda më rrëshqasin faqeve... Sa herë që isha me të, ndihesha e çliruar, e ngushëlluar, e shpirtëzuar, e pushtuar nga qetësia dhe gëzimi që rridhnin nga dashuria, nga qetësia dhe siguria me të cilën ai e kalonte jetën, jetë që ia kishte dorëzuar Zotit. Të paktën, sipas mënyrës se si kuptohet dashuria jonë. Era që frynte drejt lindjes, edhe pse nga larg mes trungjeve dhe kurorave të pemëve, nuk më ngjallte shpresë. Përkundrazi, zhurma e dallgëve që përplaseshin te muri, poshtë këmbëve të mia dhe rënga e copëtimit të tij ishte aq e fortë, diktonte regëtimat e zemrës sime, sa më dukej se dëgjonim njëri – tjetrin... Por ai nuk do të vijë. Më kishte lënë copa shpirti në çdo cep, ku unë shkelja, ishin kujtime. Pastaj e kuptova se në çdo hap që hidhja, ishte me mua... Muzgu sapo binte. Ngjita shkallët drejt urës, ktheva edhe njëherë kokën pas... Mora biçikletën dhe u dhashë këmbëve. Fluturova. Një fllad shprese m'u duk se ndizej në mua.... Ishte thirrje dashurie, që çelte me pranverën...

Pranverë, 2020



KADARE MERR TITULLIN “NDERI I BASHKISË FIER”: PËR SHKRIMTARIN, DASHURIA DHE MIRËKUPTIMI I LEXUESVE ËSHTË GJITHMONË I SHTRENJTË

Nga Maela Marini -27/05/2021 /ATSH/ Shkrimtari i madh Ismail Kadare është vlerësuar sot me titullin “Nderi i Bashkisë Fier”.

Këshilli bashkiak i Fierit i akordoi Kadaresë titullin me motivacionin: “Për kontributin e jashtëzakonshëm që i ka dhënë ndër vite letërsisë shqipe dhe për promovimin e saj në nivelet më të larta të kulturës botërore. Me angazhimin dhe talentin e tij, i ka dhënë vlerë mendimit të spikatur dhe cilësor, duke lartësuar në arenën mbarëkombëtare identitetin shqiptar”.

Kryetari i bashkisë Fier, Armando Subashi i dorëzoi titullin shkrimtarit të madh, ndërsa u shpreh se “duket sikur ne kemi nderuar të madhin Kadare, por ai na ka nderuar ne me pjesëmarrjen e tij sot këtu, ka nderuar qytetin e Fierit dhe gjithë komunitetin”.

Ismail Kadare në fjalën përshëndetëse u shpreh i kënaqur dhe

shumë i vlerësuar nga ky gjest i Bashkisë Fier dhe mikpritja fierake.

“Zoti kryetar i Bashkisë, të dashur qytetarë të Fierit, do t’ju them dy fjalë shumë të përdorura dhe që tingëllojnë ndoshta banale: Jam i lumtur që jam midis jush! Besojeni se për shkrimtarin, dashuria dhe mirëkuptimi i lexuesve është gjithmonë i shtrenjtë, shumë i shtrenjtë. Ndaj ju falënderoj nga zemra për këtë pritje kaq të bukur, kaq të ngrohtë dhe kaq njerëzore, dhe kaq shqiptare. Ju lumtë! Ju lumtë të gjithëve!”, tha Kadare.

Ceremonia e vlerësimit u organizua në formën e një konference ku referuan emra të shquar të letrave dhe kritikës shqipe si: akademiku Ali Aliu, prof. dr. Sadik Bejko, prof. dr. Klara Kodra, shkrimtarja Majlinda Rama, botuesi Bujar Hudhri etj. Në këtë aktivitet përshëndeti edhe drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli.

Referatet rreth krijimtarisë dhe karrierës së suksesshme të Kadaresë u përcollën me interpretimin brilant të aktorit të shquar Timo Flloko dhe aktorëve të teatrit “Bylis”.



KADARE
duke folur për
të pranishmit.
Majtas, kryetari
i Bashkisë Fier,
z. Armando
Subashi dhe
drejtoresha
e Qendrës
Kombëtare
të Librit dhe
Leximit, Alda
Bardhyli,
djathtas, botuesi
Bujar Hudhri

Charles Baudelaire

PORTRETE TË DASHURASH

Përktheu nga origjinali Besiana Kadare

Në një buduar burrash, domethënë një kthinë shtëpie bixhozi elegante ku pihet duhan, katër zotërinj tymosnin cigare dhe pinin. Nuk mund t'i quaje as të rinj as të vjetër, as të pashëm as të shëmtuar; por, pavarësisht nga mosha, në fytyra u dallohej shenja e pagabueshme e veteranëve të gëzimit, ajo nuk-e-di-se-çfarë e papërshkrueshme, ai trishtim i ftohtë dhe tallës që le të kuptohet qartë se: “ne kemi pasur një jetë të pasur dhe tani kërkojmë diçka që të mund ta duam e ta çmojmë”.

Njëri prej tyre e solli fjalën te gratë. Do të kishte qenë më filozofike që të mos flitej fare për këtë temë, por edhe njerëzit me mend, pasi kanë pirë mirë, nuk i përbuzin bisedat e rëndomta. Në çaste të tilla, njerëzit e dëgjojnë atë që flet siç dëgjohej një muzikë vallëzimi.

“Të gjithë burrat, po thoshte ai, kanë pasur moshën e Kerubinit32: kjo është periudha kur, në pamundësi për të gjetur nimfa pyjesh, nuk të vjen neveri të puthësh edhe trungje dushqesh. Kjo është shkalla e parë e dashurisë. Në fazën e dytë fillon

të zgjedhësh, dhe këtu fillon dekadencia. Është periudha kur burri kërkon me të vërtetë bukurinë. Për sa më përket mua, zotërinj, jam krenar për faktin që prej kohësh tashmë, kam arritur në periudhën klimaterike të fazës së tretë, kur edhe bukuria vetë nuk mjafton më në qoftë se nuk është e shoqëruar nga parfumet, stolirat e të tjera gjëra. Madje, do të thosha që disa herë, dëshiroj me gjithë shpirt, ashtu siç dëshirohet një lumturi e panjohur, ekzistencën e një faze të katërt, që do të ishte ajo e qetësisë absolute. Por gjatë gjithë jetës sime, me përjashtim të periudhës kur kisha moshën e Kerubinit, kam qenë më i ndjeshëm se askush ndaj marrëzisë nervozuese dhe mediokritetit acarues të grave. Ajo çka më pëlqen më shumë te kafshët është delirësia e tyre. Përfytyroni pra, sa shumë më ka bërë të vuaj mikesha ime e fundit.

“Ishte fëmija jashtë martese e një princi. Kuptohet vetiu që ishte e bukur; po të mos kish qenë e tillë, përse do ta kisha zgjedhur? Por ajo e prishte këtë cilësi kaq të rëndësishme me një ambicie të

pahijshme e shëmtuese. Ishte një grua që kishte gjithnjë maninë të hiqej si burrë. “Ju s’jeni burrë! Ah sikur të isha burrë! Nga ne të dy, burri jam unë!” Të tilla ishin refrenet e padurueshme që dilnin nga ajo gojë, nga e cila nuk do të kisha dashur të dëgjoja gjë tjetër përveç këngëve. Kur shprehja admirimin tim për ndonjë libër, poemë apo opera, aty për aty ajo ma kthente: “Ju ndoshta mendoni që kjo është vërtet e fuqishme? Po a e dini ju se ç’është madhështia?” dhe fillonte debatin mbi këtë çështje.

“Një ditë të bukur filloi të merrej me kimi dhe qysh atëherë unë fillova të ndiej një maskë qelqi midis buzëve tona. Përveç të gjitha këtyre, hiqej dhe si e turpshme. Kur unë guxoja të bëja ndonjë gjest pak si tepër të dashuruar, ajo tkurrej si të ishte një lule mosmëprek...


- E si përfundoi e gjitha kjo? - tha njëri nga tre të tjerët. Nuk ju dija kaq të duruar.

- Zoti, - vazhdoi ai, - ia gjeti shërimin së keqes. Një ditë e gjeta Minervën time, aq të etur për madhështi e ideal, kokë më kokë me shërbëtorin tim, në një gjendje të atillë që u detyrova të tërhiqesha pa u ndier për të mos i bërë të skuqeshin. Po atë mbrëmje i përzura të dy duke i paguar secilit atë që i takonte.

- Në rastin tim, - mori fjalën sërish ai që e kishte ndërprerë pak më parë, - unë s’mund t’i vë faj njeriu tjetër veç vetes sime. Lumturia erdhi të strehohej tek unë dhe unë s’arrita ta njoh. Këto kohët e fundit, fati më kishte dhuruar një grua, e cila ishte, pa dyshim, më e ëmbla, më e nënshtruara dhe më e devotshmja qenie e kësaj bote. Gjithmonë e gatshme! dhe pa asnjë entuziazëm! ‘Me gjithë qejf, në qoftë se kjo ju jep kënaqësi’ - kjo ishte përgjigjja e saj e zakonshme. Po t’i jepnit murit apo kanapesë një dru të mirë, ata do të nxirrnin, me siguri, më shumë rënkime sesa ç’nxirrnin vrundujt e dashurisë më të zjarhtë nga gjoksi i së dashurës sime. Pas një viti jete të përbashkët, më pohoi që s’e kishte njohur kurrë kënaqësinë. Ky dyluftim i pabarabartë m’u zvetënua atëherë, dhe ajo vajzë e pakrahasueshme u martua. Kohë më pas, më shkoi mendja ta rishikoja dhe ajo më tha, duke më treguar gjashtë fëmijë të bukur: ‘Miku im i dashur, gruaja e martuar është po aq e virgjër sa ç’ishte e dashura juaj’. Asgjë s’kishte ndryshuar tek ajo femër. Herë pas here më vjen keq që e humba; duhej të isha martuar me të”.

Të tjerët filluan të qeshnin dhe fjalën e mori një i tretë:

“Zotërinj, unë kam njohur kënaqësira që ndoshta ju i keni shpërfillur. Dua të flas për anën komike të dashurisë, por të një komiku që nuk e përjashton adhurimin. Unë e kam adhuruar të dashurën time të fundit më shumë, mendoj, sesa ju keni dashur apo urryer tuajat. Dhe të gjithë e adhuronin po aq sa unë. Kur hynim në një restorant, pas disa minutash çdokush harronte të hante për ta soditur. Kamerierët vetë, apo gruaja që rrinte te banaku, e ndienin këtë përndezeje ngjitëse që i bënte të harronin shërbimin. Për t’i rënë shkurt, kam jetuar për disa kohë vetëm për vetëm me një fenomen të gjallë. Ajo hante, përtypej, bluante, gllabëronte, gëlltiste, por me pamjen më të qetë dhe të shkujdesur që mund të ekzistojë. Më ka mbajtur kështu në ethe për një kohë të gjatë. Kishte një mënyrë të ëmbël, ëndërrimtare, angleze dhe romaneske të të thënit ‘Kam uri!’. Dhe i përsëriste këto fjalë ditë e natë duke treguar dhëmbët më të bukur në botë, që ju mallëngjenin dhe ju zbavitnin në të njëjtën kohë. Mund të kisha bërë tërë atë pasuri duke e treguar nëpër panairë si një përbindësh që ha çdo gjë. Unë e ushqoja mirë; e megjithatë, ajo më braktisi... - Për ndonjë furnizues ushqimor me siguri? - Ose diçka e përafërt, ndonjë nëpunës në intendencë, i cili ia arrinte me mënyrën e



vet t'i ofronte, ndoshta, fëmijës së shkretë një racion të denjë për disa ushtarë bashkë. Kështu ma merr mendja të paktën.

- Unë, tha i katërti, kam hequr vuajtje të tmerrshme nga e kundërta e asaj për të cilën kritikohet zakonisht femra egoiste. Ju të vdekshëm fort të lumtur, jeni me fat që keni pse të qaheni për të metat e mikeshave tuaja!”.

Këto fjalë të thëna me një ton shumë serioz, dolën nga goja e një burri me pamje të butë dhe të shtruar, me një fizionomi gati klerikale, ndriçuar për fat të keq nga ca sy gri të çelët vështrimi i të cilëve thoshte: “Unë dua!” ose: “Kështu duhet!” apo: “Unë s’fal kurrë!”.

“Në qoftë se ju G..., aq nervoz sa jeni, ose ju të dy K... dhe J..., aq frikacakë dhe të cekët sa ç’ju njoh unë, do kishit pasur marrëdhënie me njëfarë gruaje që njoh unë, ose do t’ia kishit mbathur me të katra, ose do të kishit dhënë shpirt. Unë kam mbijetuar, siç e shihni dhe vetë. Përfytyroni dikë që është i paaftë të bëjë edhe gabimin më të vogël në ndjenja ose në qëllime; përfytyroni një qetësi karakteri dëshpëruese; një devotshmëri pa komedira dhe pa teprime; një butësi pa dobësi; një energji pa egërsi. Historia e dashurisë sime i përngjet një udhëtimi të pafund mbi një sipërfaqe të pastër dhe të lëmuar si pasqyrë, marramendthi monoton, që më pasqyronte të gjitha ndjenjat dhe gjestet me përpikërinë ironike të ndërgjegjes sime, në mënyrë të atillë që unë s’mund t’i lejoja vetes një gjest apo një ndjenjë të paarsyeshme pa parë menjëherë qortimin e heshtur të spektrit tim që s’më ndahej. Dashuria po më dukej si një mbikëqyrje e mërzitshme. Sa shumë marrëzira ajo më ka ndaluar t’i bëj dhe që tani më vjen keq që s’i kam kryer! Sa borxhe të paguara kundër dëshirës sime! Ajo m’i ndalonte të gjitha përfitimet që do të kisha mundur të nxirrja nga çmenduria ime. Me ca rregulla të ftohta dhe të pakapërcyeshme, ajo u vinte fre të gjitha kapriçove të mia. Dhe ajo që e bënte më të urryer, ishte se ajo nuk kërkonte ndonjë mirënjohje pasi rreziku kishte kaluar. Sa e sa herë mezi e kam mbajtur veten për të mos iu hedhur në grykë duke i klithur: “Mos ji, pra, kaq e përsosur, femër e poshtër! që të mund të të dua pa shqetësim dhe pa mllef!”. Për vite të tëra e kam adhuruar, me zemrën plot helm. Por në fund, s’isha unë ai që gjeti vdekjen!

- Ah! bënë të tjerët, ajo paska vdekur?

- Po! nuk mund të vazhdonte më ashtu. Dashuria ishte kthyer për mua në një makth të padurueshëm. Të fitosh ose të vdesësh, siç thotë Politika, e tillë ishte alternativa që më impononte fati! Një mbrëmje, në një pyll... në buzë të një liqeni..., pas një shëtitjeje melankolike, gjatë së cilës sytë e saj pasqyronin ëmbëlsinë e qiellit, ndërsa zemra ime ishte e tkurrur si ferri...

- Çfarë!

- Si!

- Ç’doni të thoni?

- Ishte e pashmangshme. Unë e kam ndjenjën e drejtësisë tepër të fortë për të rrahur, fyer ose zburar një shërbëtor shembullor. Por më duhej ta përshtatja këtë ndjenjë me urrejtjen që më zgjonte ajo genie; ta hiqja qafe atë njeri duke pasur respekt. Ç’tjetër mund të bëja me të, meqenëse ajo ishte e përsosur?”.

Tre të tjerët e vështruan me ca sy të humbur dhe paksa të trullosur, duke bërë sikur nuk merrnin vesh dhe duke dhënë të kuptohej tërthorazi që ata vetë nuk do të kishin qenë të aftë për një akt aq të ashpër, ndonëse arsyeja ishte e mjaftueshme.

Pastaj u sollën shishe të reja, për të vrarë Kohën që e ka jetën aq të gjatë, dhe për të shpejtuar Jetën që rrjedh aq ngadalë.

Zbuloni historinë e Zelda Fitzgerald, “muza” dhe shkrimtarja që iu bë plagjiaturë nga bashkëshorti i saj i mirënjohur.

MUZA DHE SHKRIMTARJA ZELDA FITZGERALD AKUZOI PËR PLAGJIATURË BASHKËSHORTIN E SAJ F. SCOTT FITZGERALD

Nga Cati Gaya

Shumica e njohin thjesht si “gruaja e romancierit të famshëm F. Scott Fitzgerald”, por edhe Zelda Fitzgerald ishte e veçantë. Një ikonë e viteve ’20 dhe një nga figurat më tipike të së ashtuquajturës Epoka e Xhazit, ajo ishte një nga të parat flapper në Amerikë.

Flappers ishin një brez vajzash të cilat kundërsh-tonin normat dhe e shpërfillnin hapur atë që konsiderohej “sjellje e pranueshme” gjatë asaj kohe. Ato nuk mbanin korse, vishnin funde që shkonin deri te gjuri (një skandal atëherë), i prisnin flokët shkurt, dëgjonin xhaz dhe pinin alkool në publik.

Megjithatë, në radhë të parë Zelda ishte artiste. Ajo kërcente, pikturonte dhe më e rëndësishmja, shkruante. Ajo çfarë shumica e njerëzve nuk dinë – ndoshta sepse historia e ka fshehur të vërtetën – është se F. Scott Fitzgerald e arriti një pjesë të mirë të suksesit si shkrimtar falë Zelda-s. Ai jo vetëm e përdori si muzë, por u tregua i paskrupullt në vjedhjen e ideve dhe shkrimeve të saj. Zbulojeni më poshtë historinë e saj:

Përgjithmonë rebele

Gjatë fillimit të shekullit 20, gratë në Jugun e Amerikës pritej të ishin të bindura dhe të nënshtruara. E megjithatë, Zelda Sayre, lindur në Montgomery, Alabama, në vitin 1900, nuk ishte aspak e tillë. Ajo ishte aktive, rebele dhe provokuese. Ajo kërcente, pinte, tymoste dhe kërkonte qëllimisht të sfidonte konvencionet.

Thuhej se ajo lahej me rroba banje me ngjyrën e

lëkurës, për të nxitur thashethemet se ishte lakuriq në publik. Një artikull për performancat e saj në kërcim, shkruante se Zelda kishte interes vetëm te “djemtë dhe noti”.

Nuk është dhe aq e habitshme që djaloshi F. Scott Fitzgerald, i cili më vonë do të njihej si një nga shkrimtarët më të shquar të Amerikës, ra thellësisht në dashuri me të në vitin 1918, kur po qëndronte në Alabama gjatë karrierës së tij ushtarake. Ai ishte vetëm 22 vjeç. Ajo ishte 18.

Një çift filmi

Zelda dhe Scott u afruan menjëherë, ishin të dy të pashëm, të zgjuar, kureshtarë për artin dhe me talent të lindur. Gjatë viteve të para të lidhjes së tyre, Scott po shkruante librin *Kjo anë parajsës*, të cilin në fund ai e rishkroi, vetëm që të mund ta bazonte njërin prej personazheve te Zelda. Ndërsa lidhja e tyre përparonte, e njëjta gjë ndodhte edhe me rolin e Zelda-s në shkrimet e Scott-it: Zelda e lejoi të lexonte ditarët e saj, prej të cilave shkrimtari kopjoi fragmente të tëra të cilat i përfshinte te librat e tij, pa ia çmuar kontributin.

Kur u botua libri *Kjo anë e parajsës*, sukcesi ishte i jashtëzakonshëm dhe e katapultoi çiftin në rrethet shoqërore të elitës. Scott i ngjiti Zelda-s nofkën “flapper i parë i Amerikës”, duke e kthyer atë në një ikonë. Më vonë, kur Zelda ishte në ekstazë pas lindjes së vajzës së parë, ajo tha, “Shpresoj të jetë e bukur dhe budallaqe, një budallaqe e vogël dhe e bukur”, fjalë të cilat Scott i vuri në gojën e personazhit Daisy në librin e tij, *Gatsby i madh*.

Vitet e para të martesës së tyre u karakterizuan nga tepria: më konkretisht, nga shumë festa dhe alkool. Lindja e vajzës së tyre nuk i dha fund kësaj teprie, sepse ata punësuan shërbëtorë dhe dado në mënyrë që të ruanin jetesën e tyre të paqëndrueshme.

Nga muzë në shkrimtare

Festat e ekzagjeruara sollën një periudhë që u karakterizua nga tradhtia, problemet me paranë dhe debatet të cilat shpesh shkakttoheshin nga xhelozia e Scott-it. Kur Scott do të botonte librin *Të bukur dhe të mallkuar* dhe *Tribuna e New York*-ut, ai i kërkoi Zelda-s të shkruante në gazetë një recesion për të. Në artikullin dërrmues, Zelda përshkruante për herë të parë se çfarë kishte ndodhur që nga momenti kur u bënë çift:

“Më duket se në një faqe njoha një fragment nga një ditar i vjetër i imi i cili u zhduk në mënyrë të mistershme pas martesës dhe, gjithashtu, zbulova pjesë nga letra të



cilat, edhe pse tejet të ndryshuara, më ngjajnë disi të njohura. Në fakt, z. Fitzgerald (besoj se kështu e shkruan emrin) duket se beson që plagjiatura fillon në shtëpi”.

Edhe pse komentet e saj ishin me humor, shkaktuan plot debate. Kur Zelda-s filluan t'i vinin kërkesa për të shkruar libra dhe artikuj, Scott nisi të zemërohej gjithnjë e më shumë. Fakti që “muzës së tij” po i vinin mundësi për të trajtuar tematika të cilat ai dëshironte t'i përdorte për romanet e tij, ua përkeqësoi gjithnjë e më shumë lidhjen.

Kur çifti u shpërngul në Paris, Scott ishte përfshirë kaq shumë në shkrimin e romanit *Getsbi i madh*, sa që Zelda u takua dhe ra në dashuri me një pilot francez të quajtur Edouard Jozan. Kur i kërkoi bashkëshortit divorcin në mënyrë që të niste një jetë të re me dashurinë e sapogjetur, Scott jo vetëm refuzoi, por e kyçi atë në shtëpi derisa ajo e tërhoqi mbrapsht këtë kërkesë. Pasi kaloi pak kohë, Zelda tentoi të vetëvritej për herë të parë.

Rënia e “flapper” të parë në botë

Debatet dhe tensionet sa erdhën dhe u përkeqësuan, ashtu si shëndeti mendor i Zelda-s. Në vitet '20, sjellja e Zelda-s u bë gjithnjë e më tepër e paqëndrueshme dhe bashkëshorti i saj, një i alkoolizuar, u bë gjithnjë e më shumë i zemëruar me të. Zelda vendosi të merrej me kërcim, e megjithëse arriti të përparonte goxha në këtë karrierë, në fund kundërshtimi i Scott-it e dekurajoi aq shumë, sa që e refuzoi ofertën që mori për t'u regjistruar në San Carlo Opera Ballet Company, në Naples. Festat e saj dikur ekstravagante, tani ishin shkatërruese dhe dekadente. Në vitin 1930, Zelda u shtrua në një spital psikiatrik në Francë, ku u diagnostifikua me skizofreni.

Kur i bënë me dije se shëndeti i babait të saj po përkeqësohej, çifti u kthye në vendlindjen e saj në Montgomery, ku Scott-i e braktisi dhe shkoi i vetëm në Hollywood. Pasi babai i ndërroi jetë, shëndeti i saj mendor u përkeqësua edhe më shumë, dhe ajo shkonte nga njëri spital psikiatrik te tjetri.

Megjithatë këto rrethana nuk ia zbehën entuziazmin për kreativitetet. Në vitin 1932, ndërsa ishte e shtruar në spital, ajo shkroi një roman gjysmë autobiografi të titulluar *Më ruaj vals*, dhe ia dërgoi botuesit të Scott-it. Kur Scott-i e lexoi, u tërbua dhe i dërgoi disa letra ku e qortonte për atë çfarë kishte shkruar.

Ai reagoi kështu për shkak se po planifikonte të përdorte të njëjtin material për librin e tij *E butë është nata*, të cilin do ta përfundonte pas dy vitesh. Në mënyrë që të kishte mjaftueshëm material për këtë roman, Scott-i e detyroi Zelda-n të hiqte ato pjesë që ai dëshironte t'i përdorte nga libri i saj. Ky version krejtësisht i ndryshuar u botua pa ndonjë sukses. Në mënyrë ironike, bashkëshorti i saj iu shtua atyre që shkruanin recesione negative. Ai e quajti Zelda-n “një shkrimtare e dobët” dhe punën e saj e etiketoi “plagjiaturë”, duke e akuzuar për atë që kishte bërë vetë gjatë pjesës më të madhe të martesës. *Më ruaj vals* është e vetmja vepër që ajo botoi gjatë jetës. Zelda u zhgënjye thellësisht nga reagimi që solli ky libër, gjë që ia përkeqësoi gjendjen.

Trashëgimia e një brezi grash

Vite pas vdekjes së Scott-it, Zelda, e cila ishte sërish në spital, nisi të shkruante një tjetër roman, pavarësisht asaj që kishte hequr me romanin *Më ruaj vals*. Titulli i romanit të ri ishte *Gjërat e Çezarit*, megjithatë ajo nuk arriti ta përfundonte, sepse ndërroi jetë kur një zjarr shpërtheu në dhomën ku ishte kyçur, teksa priste terapinë elektrokonvulsive.

Edhe pse jeta e Zelda-s pati një fund kaq tragjik, ajo la një trashëgimi të madhe. Megjithëse bashkëshorti i saj, Scott Fitzgerald, ende njihet si një nga shkrimtarët më të shquar në historinë e Shteteve të Bashkuara, gjenia e Zelda-s po zbulohet dhe po çmohet vazhdimisht, falë botimit të biografive të ndryshme për të.

Deborah Pike, në biografinë e saj shkruan se Zelda ishte një kontribuuese me rëndësi për historinë e artit. Vepra e saj dhe vështirësitë me të cilat u përball, na ndihmojnë të theksojmë këndvështrimin femëror në artin e asaj kohe. Veprat e saj të botuara dhe ato të pabotuara, paraqesin mendimet e saj mbi

modernizmin, sëmundjet mendore dhe plagjiaturën.

Libri i autores Nancy Milford me titullin *Zelda: Një biografi*, ishte një bestseller që e bëri të njohur Zelda-n si një ikonë feministe e cila i mbijetoi bashkëshortit kontrollues që refuzonte ta ndante suksesin e tij.

Falë këtyre shkrimtareve që kanë ngritur zërin e gruas pasi është heshtur prej vitesh, njerëzit anembanë botës nuk po e njohin më Zelda Fitzgerald-in si “bashkëshortja e Scott Fitzgerald”, por si gruan e zgjuar, rebele, të talentuar, të fortë dhe unike që ajo ishte.

Përktheu David Hudhri



David Foster Wallace

PËRGJITHMONË SI PËRAN

Përktheu Ballsor Hoxha

Urime ditëlindja. Trembëdhjetshi yt është i rëndësishëm. Ndoshta dita yte e parë me të vërtetë publike. Trembëdhjetshi yt është rasti që njerëzit të kuptojnë që gjëra të rëndësishme janë duke të ndodhur.

Të kanë ndodhur gjëra gjatë gjysmës së vitit të kaluar. Tani ke parë lesh në nënsqetullën tënde. Dymbëdhjetë qime në të djathtë tënde. Spirale të forta të rrezikshme të qimeve të brishta të zeza. Lesh kafshësh, kërcitës. Tani ka më shumë lesh të dredhur të fortë rreth organeve tua gjenitale se sa që mund të numërosh pa e humbur gjurmën. Gjëra të tjera. Zëri yt është i pasur dhe gërrithës dhe lëviz në mes të oktavave pa ndonjë paralajmërim. Fytyra yte ka filluar të jetë shndritëse kur nuk e pastron. Dhe dy javë të një dhembjeje të thellë dhe frikësuese këtë pranverë të ka lënë me diçka të lëshuar prej së brendshmi: stomaku yt është tani i plotë dhe i cënueshëm, gjë që duhet të jetë i mbrojtur. Rënduar dhe lidhur në llastikë të ngushtë të cilët lënë vija në mollaqet e tua. Tani je rritur në një brishtësi të re.

Dhe ëndrrat. Për muaj me radhë ke pasur ëndrra si kurrë më parë: të lagështa, të ngarkuara dhe të largëta, përplot kthesa të nënshtuara, pistonë të çmendur, ngrohtësi dhe një rënie e madhe; dhe ti je zgjuar në mes të qepallave duke u dridhur në një ankth dhe jermi dhe një shkundjeje nga një ndjenjë gisht-mbledhëse skalp-kërcitëse nga brenda në thellësi më të madhe se që mund të kishte për ty, gulçe të dhembjes së thellë të ëmbël, dritat e rrugëve duke hyrë përmes roletave dhe duke shpërthyer në yje të mprehta përgjatë tavanit të zi të dhomës së fjetjes, dhe në ty një xhem i dendur i bardhë që fëshfërinë në mes të këmbëve, rrjedh dhe ngjitet, ftohet në ty, forcohet dhe pastrohet derisa nuk mbetet asgjë përpos nyje të gungëzuara të leshit solid të kafshës në dushin e mëngjesit, dhe në lëmshin e lagësht një aromë e ëmbël që nuk mund të besosh se vjen nga çkado që ke bërë brenda teje.

Aroma është, më shumë se çkado tjetër, sikur kjo pishinë bazeni: kripë e zbardhur e ëmbël, lule me petale kimike. Pishina ka një aromë të fortë të kaltër, edhepse e din se aroma kurrë nuk është aq e fortë se sa kur ti je brenda ujit të kaltër, sikur që je tani, i tëri i këputur së notuari, duke pushuar në fundin e cekët, sipërfaqja e ujit duke u përplasur aty ku ndërrohet i tëri. Rreth dyshemesë përreth pishinës së kësaj shkolle të vjetër publike në fundin perëndimor të Tucson-it është një gardh ciklon me ngjyrë të kallajit, dekoruar me një rrëmujë të ndritshme të biçikletave të bllokuara. Prapa kësaj një parking i nxehtë i zi përplot linja të bardha dhe vetura shkëlqyese. Një fushë e mërzitshme bari të thatë dhe e barojave të forta, kokat me push të luleradhiqeve të vjetra duke eksploduar dhe duke reshur në erën që është duke u ngritur. Dhe kaluar tërë kësaj, skuqur nga dielli i ngadalshëm i rrumbullakët i shtatorit, janë malet, dhëmbëzuar, majat e tyre kënde të mprehta duke u errësuar në kufizim përkundër një drite të thellë të kuqe dhe të lodhur. Përkundër majave të kuqe të lidhura formojnë një linjë thumbuese, një EKG të ditës në vdekje.

Retë janë duke marrë ngjyrën në buzë të qiellit. Uji është xhingla të kalte të butë, i ngrohtë i orës pesë, dhe aroma e pishinës, sikur aroma tjetër, lidhet me një mjegullim kimikë brenda teje, një turbullirë e brendshme që lakon dritën në fundet e saj, zbutë dallimin në mes të asaj që gjethet e shuajnë dhe asaj që fillon. Ndeja yte është sonte. Këtë pasdite, në ditëlindjen tënde ti ke kërkuar të vish në pishinë. Ke dashur të vish vetë, por një ditëlindje është ditë familjare, familja jote do të jetë me ty. Kjo është mirë, dhe ti nuk mund të flasësh pse ke dashur të vije vetë, dhe me të vërtetë realisht ti nuk ke dashur të vije vetë, kështu që ata janë këtu. Duke u rrezitur. Të dy prindërit e tu po rreziten. Karriget e tyre kanë shënuar kohën tërë pasditen, duke u rrotulluar, duke përcjellë lakesën e diellit përgjatë qiellit shkret nxehur si në filmat ku pjekin ve në asfalt. Motra jote luan Marko Polo afër teje me një grup të vajzave të holla të klasës së saj. Tani ajo është symbyllur, Markoja e saj është duke u Polluar. Ajo është symbyllur dhe duke u sjellë rreth thirrjeve të ndryshme, duke u rrotulluar në një rrotë të të çjerrave të vajzave në kësula

për notim. Kësula e saj ka lule të ngritura të gomës. Ka petale të squllura të vjetra që shkunden derisa ajo hidhet në zërin e verbët. Atje në fundin tjetër të pishinës është pishina për kërcim dhe kulla e dërrasës së lartë për kërcim. Prapa në dyshemenë e pishinës është BARI PËR NGRËNIE, dhe në të dy anët, ngjitur mbi hyrjet e cementuara për në dushet dhe kabinat e errëta të lagështa, janë zëruesit e hirtë të metalit të cilët dërgojnë jashtë në pishinë muzikën nga radio, zhurma e rrafshët dhe e hollë e vogël.

Familja jote të do. Je i ndritur dhe i qetë, me respekt ndaj të vjetërve – por ti nuk je pa kurriz.

Je në masë të madhe i mirë. Ti kujdesesh për motrën tënde të vogël. Ti je aleati i saj. Ti ke qenë gjashtë kur ajo ka qenë zero dhe ti ke pasur shytat kur e patën sjellë atë në shtëpi në një qebe shumë të butë të verdhë; e ke puthur për mirëseardhje në shputat e saj për shkak të kujdesit që ajo të mos i merrte shytat. Prindërit e tu thonë se kjo ndjellte mirësi. Që kishte caktuar tonin. Ata tani e ndjejnë se kishin të drejtë. Në të gjitha gjërat ata janë të mburrur me ty, të kënaqur, dhe janë larguar në distancën e ngrohtë nga e cila krenaria dhe kënaqësia udhëtojnë. Të gjithë kaloni mirë mes vete.

Urime ditëlindjen. Është ditë e madhe, e madhe sa kulmi i tërë qiellit të jug-perëndimit. E ke menduar të tërën. Aty është dërrasa për kërcim. Ata do të duan të shkojnë së shpejti. Ngjitu dhe bëje.

Shkunde të kaltrën e pastër. Ti je gjysmë i zbardhur, i lëshuar dhe i butë, i zbutur, ngjitjet mes gishtave të rrudhura. Tisi i aromës tepër të pastër të pishinës është në sytë e tu; thyen dritën në ngjyrë të butë. Godite kokën me të pasmen e dorës. Njëra anë ka një eho të squllur. Nxirre kokën anash dhe kërce – një nxehtësi e beftë në veshin tënd, e shijshme, dhe uji i ngrohur nga truri bëhet i ftohtë në anën e jashtme të moluskut të veshit tënd. Mund të dëgjosh muzikë më të thellë më të imtë, thirrje të afërta, lëvizje të shumta në ujë të shumtë.

Pishina është më e mbushur për këtë pasdite. Këtu janë fëmijët e hollë, njerëz kafshëror leshatuk. Djem joproporcional, të gjithë qafa dhe këmbë dhe kyçe të

dalura, me gjokse të cekët, disi si zogj. Sikur ti. Këtu janë të moshuarit duke lëvizur nëpër cekëtinë në shkopinj, duke ndërë ujin me duart e tyre, jashtë çdo elementi në të njëjtën kohë. Dhe vajzat – gra, gratë, lakuar si instrumente të pemëve, lëkurën kafe të ndritur të fërkuar, të lartat e kostumeve mbajtur nga nyje delikate të lidhëseve me ngjyrë të brishtë shtrënguar ndaj peshave misterioze, të poshtmet e kostumeve duke rënë poshtë mbi të dalat e buta të ijeve totalisht të ndryshme prej të tuave, enjtje dhe toptha që shkrihen në dritë në hapësirën rrethuese që mbledhë dhe akomodon lakesat si gjëra të çmueshme. Ti gati se e kupton.

Pishina është sistem i lëvizjes. Këtu tani janë: llokoçitjet, përleshjet, zhytjet, ndjekjet në kënd, gjylet, Peshkaqenët, rëniet e larta, Marko Pollo (motra jote ende është ai, gati në lot, tepër i gjatë që ajo mund të jetë ai, loja duke u lëkundur në teh të ligësisë, por nuk është puna jote të përzihesh apo të turpërosh). Dy djem të vegjël të bardhë të ndritshme mbuluar me peshqir të pambuktë vrapojnë përgjatë anës së pishinës derisa roja nuk i ndalë me një bërtimë nga amplifikuesi i zërit. Roja është po aq kafe sa një lis, qime bionde në një linjë vertikale në stomakun e tij, koka e tij në një kapelë të eksploruesit të xhunglës, hunda e tij trekëndësh i bardhë ngjyrë krem. Një vajzë ka një krahë rreth një këmbë të kullës së tij të vogël. Është i mërzitur.

Dil tani dhe kaloj prindërit e tu, të cilët janë duke u rrezitur dhe duke lexuar, dhe duke mos shikuar lartë. Harroje peshqirin tënd. Të ndalosh për peshqir do të thotë të flasësh dhe të folurit do të thotë të menduar. Ke vendosur se të qenit i frikësuar shkaktohet në të shumtën nga të menduarit. Kalo drejt pranë tyre, drejt fundit të thellë të pishinës. Mbi pishinë është një kullë e madhe e hekurt të bardhë e ndytë. Një dërrasë zgjatet nga maja e kullës sikur gjuhë. Dyshemeja e betontë e pishinës është e vrazhdët dhe e nxehtë përkundër këmbëve tua të zbardhëlluara. Secila nga gjurmët e tua është më e hollë dhe më e zbehtë. Secila zvogëlohet prapa teje në gurin e nxehtë dhe zhduket.

Linja të suxhukëve të plastikës pluskojnë rreth pishinës, që është tërësisht gjë në vete, e zbrazët nga pjesa tjetër e baletit të vrullshëm të kokave dhe krahëve. Pishina është e kaltër si energjia, e vogël dhe e thellë dhe përkryer katror, rrethuar nga linjat e shtigjeve për notim dhe BARI për USHQIME dhe dyshemeja e vrazhdët dhe e nxehtë dhe hija e vonshme e lakuar e kullës dhe dërrasës. Pishina është e qetë dhe e palëvizëshme dhe e mbyllur e patrazuar në mes të hapësirave.

Ka një ritëm me atë. Sikur frymëmarrja. Sikur makinë. Linja për dërrasën lakohet prapa nga shkalla e kullës. Rendi për në dërrasë lakohet prapa nga shkalla e kullës. Një nga një, njerëz, arrijnë shkallën dhe ngjiten. Një nga një, të ndarë nga ritmet e zemrave, ata arrijnë gjuhën e dërrasës në maje. Dhe pasi të dalin në dërrasë, ata pauzojnë, secili saktësisht të njëjtën pauzë të vogël të rrahjes së zemrës. Dhe këmbët i çojnë drejt fundit, ku të gjithë japin të njëjtin lloj të kërcimit hedhës, duart duke iu lakuar sikur të përshkruanin diçka qarkore, totale; vijnë rëndë në teh të dërrasës dhe e bëjnë atë të hidhet lartë dhe jashtë saj. Është makinë zbritëse, linjat e lëvizjes së përsëritur në një tis të vonshëm të zbardhur. Mund të shikosh nga dyshemeja derisa përplasen në sipërfaqen e ftohtë të kaltër të ujit të bazenit. Secila rënie krijon një të bardhë që ngjitet dhe bie në veten e saj dhe shkumëzohet. Pastaj vjen e pastra e kaltër në mes të bardhës dhe përhapet sikur puding, duke e bërë tërësisht të re. Uji e



shëron veten. Tri herë derisa kalon pranë.

Ti je në radhë. Shiko përreth. Duku i mërzitur. Pak bisedë në radhë. Çdokush duket vetvetja. Shumica shikojnë shkallën, duken të mërzitur. Gati të gjithë keni kryqëzuar krahët, freskuar nga një erë e vonshme e thatë në konstelacionet e klorinës së kaltër-të pastër që mbulojnë shpinët dhe supet e juaja. Duket e pamundshme se dikush mundet të jetë kaq i mërzitur. Pranë teje është tehu i hijes së kullës, gjuha e pjerrtësuar e zezë e imazhit të dërrasës. Sistemi i hijes është i stërmadh, i gjatë, i dalë jashtë, bashkëngjitur me bazën e kullës në një kënd të mprehtë të vonshëm. Gati se të gjithë në rend për dërrasën shikojnë shkallën. Djemtë më të moshuar shikojnë prapanicat e vajzave më të moshuara derisa ato ngjiten. Prapanicat janë në materiale të holla të buta, streq i ngushtë najlloni. Prapanicat e mira lëvizin lartë drejt shkallës sikur lavjerrës në likuid, kod i butë i pathyeshëm. Këmbët e vajzave të bëjnë të mendosh për drerët. Duku u mërzitur. Duku si po bënë një gjë të tejkaluar. Shiko përgjatë. Ti mund të shohësh aq mirë. Nëna jote është në karrigen e saj portative, duke lexuar, duke i hedhur sytë revistës, fytyra e saj e tërhequr lartë për të marrë dritën në faqet e saj. Nuk të ka kërkuar me shikim. Ajo pi diçka të ëmbël nga një kanaçe e ndritshme. Babi yt është në stomakun e tij të madh, linja a prapme sikur kuka e xhungës së balenës, supet duke u mbledhur me spirale kafshërore, lëkura e vajosur dhe tharë e kuqe-e kaftë me tepër shumë diell. Peshqiri jot është i varur në karrigen tënde dhe një kënd e materialit, tani lëvizë-nëna jote, e ka goditur derisa largonte një bletë të cilës i pëlqen ajo që gjendet në kanaçen e saj. Bleta kthehet menjëherë, duke u dukur sikur varet e palëvizshme mbi kanaqe në një njollë të ëmbël. Peshqiri jot është një fytyrë e madhe e Ariut Yogi. Në një pikë do të ketë më shumë rend prapa se para teje. Tash përpara teje askush përpos tre veta në shkallën e hollë. Gruaja menjëherë para teje është në shkallët e ulëta, duke shikuar lartë, veshur një kostum të ngushtë të zi najloni që është një e vetmja copë. Ajo ngjitet. Nga lartë është një gjëmim, pastaj një rënie e madhe, dhe një shtëllungë dhe uji rishërohet. Tani dy në shkallë. Rregullat thonë një në shkallë për njëherë, por roja kurrë nuk bërtet për këtë.

Kjo grua mbi ty nuk duhet të vesh kostum aq të ngushtë sikur kostumi që e ka të veshur. Ajo është po aq e vjetër sa nëna jote, dhe po aq e madhe. Ajo është tepër e madhe dhe tepër e bardhë. Kostumi i saj është i mbushur me atë. Anët e prapme të kofshëve të saj janë të ndrydhura nga kostumi dhe duken sikur djathi. Këmbët e saj kanë shenja të vogla të përdredhura të venave të ftohta të kaltra nën lëkurën e bardhë, sikur diçka të ishte e thyer, lënduar, në këmbët e saj. Këmbët e saj duken sikur vuajnë të jenë të ndrydhura, përplot linja arabike të të kaltrës së ftohtë të thyer. Këmbët e saj të bëjnë të ndjehesh sikur të dhembin vetë këmbët e tua.

Shkallët janë shumë të holla. Është e papritur. Shkallë të holla të mbërthyerë të hekurit lidhur në të sigurt. Ti shijon aromën e metalit nga aroma e lagur e hekurit në hije. Secila shkallë shtyp në fund të shputave tua dhe ti i lë gjurmët e tua. Gjurmët janë të thella dhe ato dhembin. Ti ndjehesh i rëndë. Sa e madhe i duket vetja gruas para teje. Parmakët përgjatë shkallëve janë gjithashtu shumë të hollë. Është sikur nuk do të mund të mbahesh. Duhet të shpresosh, se edhe gruaja do të mbahet për ato. Dhe sigurisht është dukur që ka më pak shkallë nga larg. Ti nuk je i marrë. Ngjitu deri në gjysmë, lartë në të hapur, gruaja e vendosur mbi ty, një njeri i fortë muskuloz në shkallë nën këmbët e tua. Dërrasa është ende lartë mbi kokë, e padukshme nga këtu. Por buçet dhe krijon një zë të rëndë dhe përplasjeje, dhe një djalë që mund ta shohësh nga disa metra nga shkallët e holla bie brenda një momenti, gjurin duke mbajtur për gjoksi, duke bërë një ‘spërkatës’. Në fushën e pamjes tënde është një pikë e stërmadhe thirrëse e shkumës, pastaj përplasje të shpërndara në shkumbëzim të gjerë. Pastaj zëri i qetë i ujit duke u shëruar në të kaltër të re prapë. Shkallë të

tjera të holla. Mbahu fort. Në këtë pikë radioja është më e zhurmshme, njëri zërues në nivel të veshit vendosur mbi kabinën e betonit. Një erë e laghtë e kabinës brenda. Kapi parmakët e hekurt shtrëngueshëm dhe kthehu dhe shiko poshtë prapa teje dhe mund të shohësh njerëz duke blerë ushqime dhe pije freskuese poshtë. Mund të shikosh prej së larti: maja e pastër e bardhë e kapelës së punëtorit, kazanët e akulloreve, ngrirësit avullues të tunxhit, tankset me sirup të pijeve të buta, gjarpërinjtë e tubave me ujë të gazuar, kutitë e fryra të palagaçeve të kriposura që rrinë të nxehta në diell. Tani që je sipër mund ta shohësh të tërën.

Ka frymë. Është më me frymë sa më lartë që arrin. Fryma është e hollë; përmes hijes është ftohët në lëkurën tënde të lagur. Në shkallën në hije lëkura jote duket shumë e bardhë. Fryma krijon një fishkëllimë të hollë në veshët e tu. Edhe katër shkallë deri në maje të kullës. Shkallët lëndojnë shputat tua. Ato janë të holla dhe të lejojnë të kuptosh sa je i rëndë. Ke peshë të vërtetë mbi shkallë. Toka të kërkon të kthehesh.

Tani mund të shohësh mbi majën e shkallës. Mund ta shohësh dërrasën. Gruaja është aty. Janë dy zhubra të kallove të kuqe me pamje të dhembjes në anët e prapme të njejeve të këmbëve të saj. Tani je mbi hijen e kullës. Njeriu i fortë poshtë teje është duke shikuar përmes shkallëve në hapësirën e kufizuar të rënies së gruas nëpër të cilën do të kaloj ajo.

Ajo pauzon për vetëm një moment të pauzës. Nuk ka asgjë të ngadalshme rreth asaj, aspak. Të bën të ftohët. Për një moment është në fund të dërrasës, lart, poshtë në të, ajo lakohet poshtë sikur të mos e dojë gruan. Pastaj tundet dhe e përplas dhe gjuan atë me dhunë lartë dhe jashtë, krahët e saj duke u hapur për të përshkuar atë hark, dhe shkon. Ajo zhduket në një kapsitje të errët. Dhe kalon kohë para se të dëgjosh goditjen poshtë.

Dëgjo. Nuk duket mirë, mënyra se si zhduket për një kohë para se të bëjë zhurmë. Sikur një guri në një pus. Por ti mendon se ajo nuk ka menduar kështu. Ajo ishte pjesë e një ritmi që përjashton të menduarit. Dhe tani e ke bërë veten pjesë të saj, gjithashtu. Ritmi duket i verbër. Sikur buburrecat. Sikur makinë. Ti vendos se kjo ka nevojë të mendohet. Mund të jetë mirë, në fund të fundit, të bësh diçka të frikshme pa menduar, por jo kur frika është të mos menduarit vet. Jo kur të mos menduarit duket i gabuar. Në një pikë gabueshmëria është bërë përgjigje të verbër: shtirje-mërz, peshë, shkallë të holla, shputa të lënduara, hapësirë e ndarë në pjesë të shkallëzuar të cilat shkrihen së bashku vetëm në një zhdukje që merr kohë. Era në shkallë nuk është ajo që çdokush do ta kishte pritur. Mënyra se si dërrasa zgjatet nga hija në dritë dhe ti nuk mund ta shohësh fundin. Kur e tëra duket të bëhet si e ndryshuar ti duhet të fillosh të mendosh. Duhet të kërkohet. Shkalla është përplot përfund teje. E mbërthyer, çdonjëri disa shkallë i ndarë prej tjetrit. Shkalla kalon nga një linjë e fortë e cila zgjatet prapa dhe lakohet në të errëtën e hijes së rrëzuar të kullës. Duart e njerëzve janë të kryqëzuara në vijë. Ata në këmbët e shkallës të lënduar dhe të gjithë janë duke shikuar lart. Është makinë që lëviz vetëm përpara. Ngjitu në gjuhën e kullës. Dërrasa del të jetë e gjatë. Për aq kohë sa qëndron aty. Koha ngadalësohet. Trashet përreth teje derisa zemra jote nxjerrë më shumë rrahje nga çdo sekondë, çdo lëvizje në sistemin e pishinës përfund. Dërrasa është e gjatë. Prej aty ku qëndron duket të zgjatet në asgjë. Do të dërgoj në një vend gjatësia e të cilës nuk të lejon ta shohësh, i cili duket i gabuar për t’u dorëzuar as pa menduar. Shikuar nga një anë tjetër, e njëjta dërrasë është vetëm një gjë e gjatë e hollë e mbuluar me gjë të bardhë plastike. Sipërfaqja e bardhë është shumë e vrazhdët dhe është me prenka dhe e vijëzuar me të kuqe të zbehtë që është ende e kuqe dhe ende jo rozë—pika të ujit të vjetër të pishinës që janë duke kapur dritën e diellit të vonshëm mbi malet e mprehta. Gjëja e bardhë e vrazhdët e dërrasës është e lagur. Dhe e ftohtë.

Shputat tua janë të lënduara nga shkallët e holla dhe kanë aftësi të madhe për të ndjerë. Ato ndjejnë peshën tënde. Ka parmak që shkojnë deri mbi fillimin e dërrasës. Nuk janë sikur parmakët e shkallës. Janë të trashë dhe të vendosur shumë poshtë, kështu që gati të duhet të lakohesh mbi ‘to. Ato janë vetëm për shfaqje, askush nuk i kap. Të mbajturit merr kohë dhe ndërron ritmin e makinës.

Është plastikë e gjatë e ftohët e vrazhdët apo dërrasë leshi xhami, vijëzuar me ngjyrë të përafërt me të rozës çokollate të keqe.

Por në fund të dërrasës së bardhë, tehut, aty ku do të vishë me peshën tënde për ta bërë të të hedhë, aty janë dy hapësira të errësirës. Dy hije të rrafshita në dritë të hapur. Dy ovale të zeza. Fundi i dërrasës ka dy njolla të pista.

Ato janë nga të gjithë njerëzit që kanë kaluar para teje. Shputat e tua derisa ti qëndron këtu janë të buta dhe të shtypura, lënduar nga sipërfaqja e vrazhdët dhe e lagur, dhe ti e sheh se dy njollat e errëta janë nga lëkura e njerëzve. Ato janë lëkurë e fërkuar nga shputa prej forcës së zhdukjes së njerëzve me peshë të vërtetë. Më shumë njerëz se që mund të numërosh pa e humbur gjurmën. Pesha dhe fërkimi i zhdukjes së tyre lë pjesë të këmbëve të buta prapa, pjesë dhe cila dhe dredhje të lëkurës që përlyejnë dhe errësojnë dhe rreziten derisa shtrihen të holla dhe të njollosuara në diell në fund të dërrasës. Ato grumbullohen dhe njollosen dhe përzihen së bashku. Ato errësohen në dy rrumbullakë.

Nuk kalon fare kohë jashtë teje. Është e çuditshme. Baleti i vonshëm poshtë është xhirim i ngadalësuar, lëvizjet e sipërme prej xhelatinës së kaltër. Nëse do mund të rrisht këtu përgjithmonë, duke vibruar brenda aq shpejtë ti pluskon i palëvizshëm në kohë, sikur bletë mbi diçka të ëmbël.

Por ata do të duhej ta pastronin dërrasën. Kushdo që ka menduar për këtë qoftë edhe për një sekondë do të shihte se duhet pastruar fundin e dërrasës nga lëkura e njerëzve, të dy grumbujve të zi të asaj që ka mbetur nga më parë, njolla që nga këtu prapa duken sikur sy, sikur sy të verbër.

Aty ku ti je tani është ende qetë dhe pa zhurmë. Radio duke u dëgjuar por jo këtu. Pa kohë dhe pa zë të vërtetë përpos gjakut tënd duke angulluar në veshët e tu.

Sipër këtu nënkupton pamje dhe aromë. Aromat janë intime, të pastra. Aroma e lules speciale të zbardhuesit, por prej saj gjëra të tjera ngrihen tek ti sikur borë e mbjellë e barit. Ti ndjenë palagaçe të thella të verdha. Vaj të ëmbël për rrezitje sikur kokos i nxehtë. Ose hot-dog. Aromë të hollë të ligë të Pepsit shumë të errët në gota të letrës. Dhe aromë speciale të tonelatave të ujit duke ardhur nga tonelata të lëkurës, duke u ngritur sikur avull nga një banjë e re. Nxehtësi kafshërore. Nga sipër është më reale se çka do tjetër. Shiko në ‘të. Mund ta shohësh tërë gjënë e komplikuar, kaltër dhe bardh dhe kafe dhe bardh, lagur në xhingël uji të të kuqes së thellë. Të gjithë. Kjo është ajo që njerëzit e quajnë pamje. Dhe e ke ditur se nga poshtë nuk do të dukesh aq lartë sipër. Tani e sheh sa sipër je. E dije se nga aty poshtë askush nuk mund ta thotë.

Ai prapa teje e thotë, sytë e tij në nyell, njeriu i fortë, Hej djalosh. Ata duan ta dinë. Nëse planet e tua këtu lartë përfshijnë tërë ditën apo çka në të vërtetë është ndodhia. Hej djalosh a je mirë.

Ka pasur kohë gjatë tërë kësaj kohe. Nuk mund ta mbysësh kohën me zemrën tënde. Çdo gjë merr kohë, bletët lëvizin shumë shpejtë për të qenë të qeta.

Hej djalosh thotë ai. Hej djalosh a je mirë. Lule metali çelin në gjuhën tënde. Nuk ka më kohë për të menduar. Tani që ka kohë ti më nuk ke kohë.

Hej.

Ngadalë tani, përgjatë çdo gjëje, ka një të shikuar që përhapet sikur unazat e goditura të ujit. Shikoje duke u përhapur nga shkalla. Motra jote e vërejtur dhe grupi i saj i hollë i bardhë, duke shënjuar. Nëna jote shikon në cekëtinë aty ku ishe, pastaj bënë një strehë me dorën e saj. Balena lëviz dhe tundet. Roja shikon lartë, vajza përreth këmbëve të tij shikon lartë, ai merr altoparlatin e tij. Përherë poshtë është dyshemeja e vrazhdët, ushqimet, muzika e hollë metalike, poshtë aty ku ke qenë njëherë; linja është solide dhe nuk ka shpejtësi të kthimit prapa; dhe uji, natyrisht, është i butë vetëm kur je brenda tij. Shiko poshtë. Tani lëviz në diell, përplot monedha të forta të dritës të cilat shndrisin derisa zgjaten në mjegull që është kripa jote e ëmbël. Monedhat zbërthehen në hëna të reja, cila të gjata të dritës nga zemrat e yjeve të pikëlluara. Uji i pishinës i rrafshët është një mbulesë e ftohët e kaltër. Të ftohtit është vetë një lloj i fortësisë. Një lloj i verbërisë. Je nxënë i pambrojtur. Urime ditëlindjen. A e kishe menduar më herët. Po dhe jo. Hej djalosh.

Dy njolla të zeza, forcë, dhe zhduku në një pus të kohës. Lartësia nuk është problem. E tëra ndryshon kur kthehesh poshtë. Kur godet me peshën tënde.

Pr a cila është gënjeshtër? Fortë apo butë? Qetësia apo koha?

Rrena është se ose është njëra ose tjetra. Bletë e qetë, pluskuese është duke lëvizur më shpejt se që mund të mendoj. Nga sipër ëmbëlsia e çmend atë.

Dërrasa do të lëkundet dhe ti do të kërcesh, dhe sytë e lëkurës mund të verbërohen në një qiell të njollosur me re, drita e shpuar duke zbratur prapa guri të mprehtë që është përgjithmonë. Kjo është përgjithmonë. Shkel në lëkurë dhe zhduku.

Tungjatjeta.



A ËSHTË FAJTORE ZONJA BOVARI?

Nga Desara Tollumi

Ajo nuk është Zonja Bovari, përkundrazi ajo është veçse Ema, e thjeshta, e brishta dhe ëndërrimtarja e manastirit, që u rrit midis faqeve të librave sentimentale e romantikë, ëndërrimet e së cilës më vonë do ta torturonin shpirtin e saj, duke e kthyer kështu në femrën më të GJYKUAR të shoqërisë.


Ndryshe nga Floberi që i dha jetë, unë s'do ta cilësoj Emën në esenë time "persekutuese" me titullin "Zonja Bovari", përkundrazi do ta quaj thjesht EMA, sepse që ta quaj atë "ZONJA BOVARI", atëherë më duhet të tregoj prova që ajo i përkiste me të vërtetë Sharli Bovarisë (doktorit aspak ambicioz të një fshati të përhumbur francez, monotonia e të cilit e kishte mbytur). Mirëpo Ema përveçse me unazë dhe letra bashkëshortore, me asnjë fije më shumë prove nuk i përkiste Zotit Bovari.

Ndonëse ata ishin të martuar Ema nuk ndjehej e lirë ta dashuronte, t'i përkëdhelte shpirtin, ta ngrohte me ndjenjat e saj të fuqishme emocionale, sepse nuk ishte epiqendra zotëruese apo sunduesi i zemrës së saj, përkundrazi ai ishte "gabimi" i ëndërrimeve të Emës, që e hodhën atë në krahët e monotonisë së përjetshme.

Ajo është një flad i lëkundshëm, që nuk mund të zgjedh dot se në cilën stinë preferon të fryjë e të trazojë natyrën me ashpërsinë aventuriere që e karakterizon; thellë thellë ajo nuk është asgjë që mendon se është.

Ema është një e panjohur e vetes së saj!

"Dantella të lehta si dëbora, copëza të punuara me argjend e të kombinuara me perla të vogla nga detet e pasura të Bregut të Fildishtë, këpucë të larta rozë mbretërore, varëse të rënda në peshë, por elegante në pamje, të varura në gjysmë gjoksit e zbuluar të atyre zonjave aristokrate, që dalin nga dyert e arta të aristokracisë". Atëherë kur ora troket 3 pas mesnate, kur akrepi shënon 9 në mëngjes, minutat plotësojnë 60 sekondëshin e plotë mbi orën 19, ëndërrimet e Emës çlirohen nga portat e fuqishme të mendjes së saj iluzioniste dhe i shkatërrojnë realitetin që ajo s'mundet të marrë guximin ta shohë në sy, thua sikur ai të jetë aq verbues sa dielli. Ëndërrimet e shfrenuara romantike të vogëlushes së manastirit të dikurshëm, gjetën forcën të përparonin e ta kthenin atë në gruan më të zhgënjyer, në iluzionisten tekanjoze, të përhumburën në valën e dashurisë që kurrë s'ia mësoi trajtën në kohën e duhur.



Ema për mua është një nga ato femra që nuk e dinë asnjëherë se kur është koha e duhur për të vepruar, por gjithmonë gabojnë në vështrimin e orës.

Fakti që ajo e ngatërroi emocionin më dashurinë, vjen si rezultat i mos provimit të asaj ndjenje më parë si dhe shkak i atyre ëndërrimeve të gënjeshtërtë, të cilat kërcenin nga faqet e librave dhe pushtonin ajrin e Emës, atë ajër që më vonë i mori frymën. Fajtores apo jo, mbetet njeri e si një njeri, ajo kërkonte emocionin, mirëkuptimin, dashurinë, përkëdheljen, elegancën dhe të mahnitshmen, por e dashur Ema, a e pyete ti zemrën nëse ishte Sharli melodia që i bënte ziklat e zemrës tënde të kumbonin?

Aspak, sytë e tu u veshën nga pallatet e larta se mendoje që do të gjeje, mendja jote kaloi në dimensionin e ëndërrimeve, trupi yt iu dha me shpirt arratisjes, ndërkohë zemra jote ishte një e paftuar në këtë diskutim.

Vuajë zgjedhjen tënde!

Ndonëse Floberi nuk të bëri kurrë fajtores, ai thjesht të veshi ty justifikimet e atyre gjërave e ndjesive që bashkëshorti yt s'mund të t'i plotësonte, në sytë e mi nuk je aspak e pafajshme, as e gjykuar, por veçse e zbardhur nga hynorja dhe e moralshmja, pasi ti nuk mund të kërkosh të plotësosh vetëm veten tënde, duke mos menduar për hapësirën bosh që do të lësh në zemrën e dikujt.

Do të ishte më e ndershme mos e kishe zgjedhur kurrë Sharlin, mjeranin trashalug, paratë e të cilit i gropose mbas dashnorëve të tu.

Më shumë se për tradhëtinë do të të gjykoja për mosinteresimin tënd si nënë ndaj vogëlushes tënde, ndaj asaj krijese të pafajshme pjellë e emocionit të natës së parë të martesës, jo si një pjesëz e shkëputur prej dashurisë së mirëfilltë. Ti je fajtores e dashur, por tradhtia jote s'është aspak fajtores, për aq kohë sa justifikohet nga Floberi, por jo nga unë.

Ah, para se ta mbyll këtë ese, Rodolfi është një frikacak i vërtetë, sepse ai të bëri ta dashurosh pa qenë vetë gati për të të dashuruar; Leoni ishte një djalosh që e emocionove ashtu sikurse Sharli të emocionoi ty; Sharli ishte një i ve i përjetshëm, ndërsa ti, epo ti ishte Flladi që fryje nga të të çonte moti i stinës së shpirtit tënd.

Autorja është maturante në gjimnazin "Dh. Todri", Elbasan



MIRA MEKSI

Kutia e Agatha Christie-t

OnufriRoman